






# Ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi i opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat: udhëzim

*Funded by*

AUSTRIAN RED CROSS

AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION

Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

International Federation
of Red Cross and Red Crescent Societies

# PËRMBAJTJA

Shkurtesa dhe akronime .................................... 04
Fjalor I termeve .................................... 06

## 1.Hyrje 08

Pse nevojitet ky udhëzim? .................................... 08
Informacione elementare: publikime .................................... 10
Si është përgatitur ky doracak? .................................... 11
Përmbajtja e doracakut .................................... 12

## 2. Planifikim: Pyetje të cilat duhet të parashtrohen 15

Pse është aq e rëndësishme iniciativa? .................................... 15
Për kë është dedikuar kjo iniciativë? .................................... 18
Prej çka mund të përbëhet iniciativa? .................................... 19
Me kë duhet të punojmë? .................................... 20
Kur dhe ku iniciativa është adekuate? .................................... 24
Me cilën mënyrë do t'I prijmë iniciativë? …................................ 26
Cilat mjete duhet t'I përdorim? .................................... 27
Çka duhet tjetër të kemi parasysh? .................................... 28

## 3.Katër qasje kyçe 30

Fushata .................................... 30
Mësimi participativ .................................... 34
Edukim joformal .................................... 38
Intervenime formale në shkolla .................................... 41

## 4. Parime të implementimit efektiv 48

Parimi 1: Porosi standarde .................................... 48
Parimi 2: Legjitimitet dhe kredibilitet .................................. 51
Parimi 3: Vëllimi .................................... 53
Parimi 4: Qëndrueshmëria .................................... 55

## 5.Mjete 56

Publikime ................................... 56
Programe mësimore, module dhe prezantime ................................... 60
E-mësim ................................... 63
Pika artistike ................................... 66
Lojëra dhe gara ................................... 67
Audio dhe video materiale ................................... 69
Resurse interneti ................................... 74
Media sociale ................................... 76
Telekomunikime ................................... 78
Mjete të kombinuara ................................... 80

## 6.Sigurimi i kualitetit 81

Porosi të përgatitura mirë ................................... 81
Fotografi që tregojnë shumë ................................... 82
Ton ngushëllues ................................... 83
Përmbajtje e adaptuar, lokalizuar ................................... 84

## 7.Menaxhimi i diturive 87

Monitorim dhe evaluim ................................... 87
Shpërndarja e diturive ................................... 89
Ndërtimi i kapaciteteve ................................... 92

## Letërsia e përdorur 95

## Anekse 101

## Shkurtesa dhe akronime

| | | | |
|---|---|---|---|
| MKB | Menaxhimi i katastrofave në bashkësi | CBDM | Community-based disaster management |
| KSHNPB | Kujdesi shëndetësor dhe ndihma e parë në bashkësi | CBHFA | Community-based health and first aid |
| URK | Ulja e rreziqeve nga katastrofat | DRR | Disaster risk reduction |
| FNSHKKGJHK | Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe | IFRC | International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies |
| SNURR | Strategjia ndërkombëtare për uljen e erreziqeve | ISDR | International Strategy for Disaster Reduction |
| OJQ | Organizata joqeveritare | NGO | Non-governmental organization |
| SNURRKB | Strategjia ndërkombëtare për uljen e rreziqeve të Kombeve të bashkuara | UNISDR | United Nations International Strategy for Disaster Reduction |
| UNDP | Programi zhvillimor i Kombeve të bashkuara | UNDP | United Nations Development Programme |
| VMK | Vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve | VCA | Vulnerability and capacity assessment |

## *Ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi i opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat - Udhëzim*

Strategjia 2020 e shpreh vendosjen kolektive të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të vazhdohet edhe më tej në ballafaqimin me sfidar kryesore me të cilat do të ballafaqohet njerëzimi në dekadën në vijim.

Informuar për nevojat dhe mjerueshmëritë e bashkësive me të cilat punon, si dhe të drejtat dhe liritë elementare në të cilat të gjithë kanë të drejtë, kjo strategji ka për qëllim që t'ju dalë në krah atyre njerëzve të cilët presin nga Kryqi i kuq / Gjysmëhëna e kuqe të ndërtojë një botë më humane, më dinjitoze dhe më të qetë.

Në dhjetë vitet e ardshme vëmendja kolektive e Federatës ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe do të jetë e drejtuar kah realizimi i qëllimeve strategjike në vijim:

- Shpëtimi i jetës, mbrojtja e pasurisë dhe përforcimi i aktiviteteve për rimëkëmbje nga katastrofa dhe situatat e krizës.
- Sigurimi i jetës së shëndoshë dhe të sigurt.
- Promovimi i kyçjes sociale dhe kultura e mos dhunës dhe paqes

# FJALORI I TERMEVE

| | |
|---|---|
| **Katastrofa** | Shkatërrim serioz i funksionimit të bashkësisë apo shoqërisë që rezulton me humbje apo pasoja të mëdha njerëzore, materiale, ekonomike të mjedisit jetësor të cilët e tejkalojnë mundësinë e bashkësisë apo shoqërisë së goditur të ballafaqohet me këtë situatë me resurse personale. |
| **Ulja e rrezikut nga katastrofa** | Koncept dhe ushtrim i uljes së rreziqeve nga katastrofat nëpërmjet orvatjeve sistematike për analizimin dhe menaxhimin e faktorëve të zakonshëm në katastrofa, vetëm nëpërmjet uljes së shfaqjes së rreziqeve, mjerueshmëri e ulur të njerëzve dhe pasurisë, menaxhim i mençur me tokën dhe mjedisin jetësor, dhe përmirësim të përgatitshmërisë nëpërmjet organizimit të ngjarjeve adekuate për trajnim. |
| **Rrezik** | Dukuria e rrezikshme, aktiviteti apo gjendja e njeriut e cila mund të shkaktojë humbjen e jetës, lëndimi apo ndikimi tjetër për shëndetin, pasurinë, humbjen e bagëtisë, mosfunksionimi i shërbimeve, prishja e gjendjes sociale dhe ekonomike e mjedisit jetësor. |
| **Lehtësimi i situatës** | Ulje apo kufizim të ndikimeve të padëshirueshme të rrezikut dhe katastrofave. |
| **Përgatitshmrëi** | Dituri dhe kapacitete të përgatitura nga ana e pushteteve, organizatave profesionale për përgjigje dhe rimëkëmbje gjatë katastrofave, dhe të bashkësive dhe individëve, në mënyrë efektive të parashikojnë e të përgjigjen dhe të rimëkëmben nga ngjarjet dhe situatat e mundshme, që nuk mund të tejkalohen apo vijuese. |
| **Preventivë** | Aktivitete për tejkalimin e ndikimeve të padëshirueshme nga rreziqet e shkaktuara nga llijet e ndryshme të katastrofave. |
| **Ngritja e vetëdijes publike** | Shkalla e njohurisë publike për rreziqe nga katastrofat, faktorët që shpien në katastrofa dhe aksionet të cilat mund të ndërmerren, në mënyrë |

| | |
|---|---|
| | individuale dhe kolektive, që të ulet shfaqja dhe mjerueshmëria e rreziqeve. |
| **Rrezistencë** | Aftësia e sistemit, bashkësia apo shoqëria e cila është në rrezik të ballafaqohet, t'i apsorbojë ndikimet, të adaptohet dhe të rimëkëmbet nga efektet e rrezikut në kohë dhe në mënyrë efikase, kyçur edhe nëpërmjet mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së strukturave dhe funksioneve esenciale elementare. |
| **Rrezik** | Mundësia që të ndodhë një ndodhi e caktuar dhe pasojat nga ajo ndodhi. |
| **Mjerueshmëri** | Karakteristikat dhe rrethanat në bashkësi, sistem apo mjedis të cakktuar që i bën nënshtruese efektet e dëmshme të rrezikut. |

# Hyrje

Kryqi i kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe kanë traditë të gjatë në edukimin e bashkësive për rreziqet nga katastrofat, rritje të sigurisë nëpërmjet fushatave, edukimit joformal, mësimit participues dhe intervenimet formale në shkolla. Shoqatat nacionale kanë përgatitur spektër të gjërë të mjeteve për përkrahjen e këtyre aktiviteteve. Në një studim të zbatuar në periudhën prej vitit 2005 deri në vitnin 2008 është zbuluar se 50 prej 82 shoqatave nacionale kanë zbatuar aktivitete të strukturuara edukative për ngritjen e vetëdijes dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat, prej të cilave 38% kanë të bëjnë me fëmijët dhe shkollat.

Ky udhëzim është dizajnuar që t'ju ndihmojë shoqatave nacionale të planifikojnë dhe të përgatisin aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Dokumenti është përgatitur në kuadër të implementimit të *strategjisë 2020* të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe *Kornizës për siguri dhe përforcim të rrezistencës në bashkësi gjatë rreziqeve nga katastrofat,* dhe ka për qëllim të sigurojë përkrahjen e implementimit të *Kornizës për aksion nga Hjogo* – korniza globale për uljen e rreziqeve nga katastrofat për periudhën prej 2005 – 2015 – nëpërmjet sigurimit të kahjeve specifike operative për promovimin e uljes së rreziqeve nga katastrofat me qëllim që të sigurohen rezultate më të suksesshme. Në të ardhmen presim të përgatiten edhe porosi të standardizuara dhe të harmonizuara me udhëzime teknike për implementimin e këtij dokumenti.

## Pse nevojitet ky udhëzim?

Për momentin përkushtohet vëmenjde e posaçme në aktivitetet për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Theksi bie në 4 fusha kryesore:

- **Shëndeti publik –** kjo pjesë paraqitet si e para me qëllim që në mënyrë të guximshme të tregohet se sjallja e njerëzve mund të ndryshohet dhe të çrrënjosen sëmundjet. Ekzistojnë shumë shembuj për orvatje të suksesshme ku edukimi i opinionit ka kontribuar për ndryshime dramatike në bazë të sjelljes së njerëzve, si për shembull: uji për pije, hidracioni, larja e duarve, siguri në komunikacion, ndalimi i përhapjesë së sëmundjeve nëpërmjet ujit dhe ajrit, përmirësimi i medikamenteve, ndalimi i pirsjes së duhenit, shërimi i tuberkulozit dhe vendosja e rripave të sigurimit.
- **Mbrojtja e mjedisit jetësor -** aktivitetet promovojnë ngritjen e vetëdijes në bazë të ndikimit të aktiviteteve të njerëzve në mjedisin jetësor. Si rezultat i asaj se ekzistojnë shumë e më shumë aktivitete dhe orvatje të njerëzve në nivel familjar dhe në bashkësi drejtuar kah mbrojtja e mjedisit jetësor. Gjithashtu, edukimi ndikon në përmirësimin e rrgulloreve për

mbrojtje nga materiet e rrezikshme, energjitë e sigurta dhe ripërtrirëse, riciklimi dhe ruajtja e ujit.

- **Shkenca për tokën dhe gjeologjia –** shkenctarët për tokën dhe gjeologët filluan të ndajnë diturinë në bazë të mekanizmave për rreziqe natyrore në vitet 1970, që solli në ngritje të dukshme të vetëdijes për mbrojtje nga katastrofat natyrore nëpërmjet agjendës më të mirë si kontribut i shkencës dhe gjeografisë.
- **Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe –** shumë dekada, Lëvizja ka një rol aktiv në përparimin e edukimit publik me theks në ndihmën e parë dhe përmirësimin e mekanizmave për gadishmëri dhe veprim në bashkësi dhe familje gjatë situatave emergjente. Qysh në vitin 1996 Gjysmëhëna e kuqe e Bangladeshit, me përkrahjen e Kryqit të kuq të Suedisë, i edukon bashkësitë për përgatitjen e sistemit për paralajmërim të hershëm për mbrojtje nga cikloni. Këto aktivitete përparuan dukshëm gjatë Dekadës ndërkombëtare për Uljen e Rreziqeve nga Katastrofat, gjatë viteve 1990.

Për Lëvizjen, publikimi *Më mirë preventivë se sa Shërim – Raport për katastrofa shkaktuar nga njeriu dhe katastrofa natyrore në Botën e tretë* botuar në vitin 1984, tregon se apelet e kufizuara për katastrofa dhe raportet mediale gabimisht i japin popullit impresione se katastrofat janë të pashmangshme. Këto porosi e fshehin porosinë më të rëndësishme: se ka "elemente të rëndësishme të cilat janë vepër e njeriut në të gjitha llojet e katastrofave", dhe se shumë është me rëndësi të kuptohet me qëllim të veprohet në arsyet rrënjësore me qëllim që të ndalohen ato.

Dokumenti vazhdon edhe më tej: "Pasi të kuptohen këto gjëra elementare, nevojitet ngritje e mëtutjeshme e vetëdijes në bazë të opsioneve të ndryshme të nevojshme të cilat duhet të ndërmerren për ndalimin e katastrofave. Trajnimi në bazë të ngritjes së vetëdijes ekologjike është një gjë edhe më e rëndësishme, por gjithashtu është shumë me rëndësi të kuptohen njerëzit dhe sjellja e njeriut.

E gjithë kjo tregon në nevojën për rritjen e fokusit të ngritjes së vetëdijes së opinionit, dhe sigurimi i edukimit, që të ulet rreziku nga katastrofat. Ky doracak do t'ju ndihmojë të punësuarve dhe vullnetarëve në planifikim më të mirë të strategjive, programeve dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Së shpejti në Prioritetin 3 të Kornizës për Aksion nga Hjogo është definuar si në vijim: *Të përdoret dituria, inovacionet dhe edukimi për ndërtimin e kulturës së sigurisë dhe rrezistencës në të gjitha nivelet, dhe kjo të zbatohet nga praktikuesit në terenin e fushës së sigurimit të zhvillimit për përkrahje dhe përgjigje humanitare.*

Ky doracak ka për qëllim t'ju ndihmojë shoqatave nacionale ta plotësojnë këtë prioritet me atë që i prezanton të gjitha informacionet të cilat janë të nevopjshme të grumbulluara në një vend.

## Informacione edlementare: publikime

Lëvizja mundohet ta prezantojë vizionin e vet nëpërmjet një numri të caktuar të dokumenteve mes cilave edhe këtë publikim.

Në vizionin e Federatës ndërkombëtare në Strategjia 2020 qëndron se Lëvizja planifikon ta inkorporojë punën e vet në drejtim të uljes së rreziqeve nga katastrofat, promovimi i shëndetit më të mirë dhe mbrojtje nga ndryshimet klimatike nëpërmjet tentimeve globale për ndërtimin e bashkësive të sigurta dhe rrezistuese. Në ndërkohë, korniza për siguri në bashkësi dhe përforcimi i rrezistimit gjatë rreziqeve nga katastrofa i definon elementet kyçe për implementimin e përgjigjes humanitare, aktivitete për lehtësimin e pasojave nga katastrofat, aktivitete për preventivë dhe adaptim dhe programime sektoriale.

Ky doracak në hap esencial kah implementimi i vizionit vërtetuar në Strategjia 2020 me atë që vërtetohen qasje të përbashkëta, mjete dhe kahje të nevojshme dhe porosi standarde që e tejkalojnë kornizën dhe kontekstin nacional.

Strategjia 2020 tregon se ka nevojë "Të bëhet më shumë, të bëhet më mirë, të arrihet më largë", me 3 qëllime strategjike:

- Shpëtimi i jetës, mbrojtja e pasurisë dhe përforcimi i aktiviteteve për rimëkëmbje nga katastrofat dhe situatat në krizë.
- Sigurimi i jetës së shëndoshë dhe të sigurtë.
- Promovimi i kyçjes sociale dhe kulturës kundër dhunës dhe promovimi i paqes.

Ulja e rreziqeve nga katastrofat është detyrë eksplicite e rëndësishme e mandatit të Lëvizjes në nivel global. Ky viziomn kontribuon për zhvillim dhe përforcim të qëndrueshëm të rrezistencës së bashkësive, promovimit të shëndetit më të mirë, ulje të rreziqevenga katastrofat dhe mbrojtja e ndryshimeve klimatike.

Në vitin 2009 lëvizja përgatiti *Kornizë për siguri dhe përforcim të rrezistencës në bashkësi gjatë rreziqeve nga katastrofat.* Kjo kornizë paraqet bazën bazë për të gjitha programet, projektet dhe interventimet e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe të dizajnuara të kontribuojnë në ndërtimin e bashkësive të sigurta dhe rrezistuese. Elementet kyçe të kësaj kornize janë:

- Përgjigje humanitare në bazë të rreziqeve të detektuara.
- Aktivitete për lehtësim, preventivë dhe adaptim në bazë të kontekstit specifik të vendit.
- Programim bazuar në nevojat e sektorëve të ndryshëm.

Aviokativiteti, edukimi dhe ngritja e vetëdijes janë komponente të kryqëzuara të cilat duhet t'i kenë parasysh të gjithë në proces. Shtyllat kyçe në të cilat ato

mbështeten në kontekstin nacional janë: ekzistimi i qasjes së përbashkët, mjete dhe udhëzime e porosi standarde.

Konteksti global për uljen e rreziqeve nga katastrofat është bazuar në bazë të kornizës për aksion nga Hjogo, që u miratua nga 168 shtete në vitin 2005. Prioriteti numër 3 nga kjo kornizë që përbëhet prej 5 pikave është "të përdoret dituria, inovacionet dhe edukimi për ndërtimin e kulturës së sigurisë dhe rrezistimit në të gjitha nivelet". Si partner i Strategjisë ndërkombëtare ka për qëllim që orvatjet e veta të jenë në drejtim të sigurimit të përkrahjes së bashkësisë më të gjërë gjegjësisht sigurimin e përkrahjes së organizatave humanitare dhe zhvillimore, si dhe vepruesit e sektorit publik, privat dhe qytetar që punojnë në realizimin e këtyre qëllimeve.

## Si është përgatitur ky doracak?

Për përgatitjen e këtij doracaku, Federata ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe zbatoi studim vëllimor me qëllim që të studiohen qasjet dhe strategjitë të cilat tani më janë në prdorim në domenin e edukimit publik dhe uljen e katastrofave në kuadër të Lëvizjes. Këtu nënkuptojmë:

- Zbatimi i studimit gjithëpërfshirës, gjegjësisht studimi i mbi 150 dokumenteve.
- Studimi i më shumë se 150 ueb faqeve.
- Intervistimi i 50 të të punësuarve nga shoqatat nacionale nga e gjithë bota.

Këto udhëzime janë prezantuar në këtë dokument të përcjellë me udhëzime të cilat dalin nga studimi për rreziqe në domenin e kominikimeve, marketingut social dhe edukimit të opinionit për ndryshimet në sjellje.

Më poshtë janë prezantuar dokumente të Federatës ndërkombëtare ku janë integruar aspekte të këtij doracaku në kontekstin më të gjërë të aktiviteteve të Federatës ndërkombëtare në sferën e uljes së rreziqeve nga katastrofat.

### Dokumente kyçe referente të Federatës ndërkombëtare:

- Strategjia 2020
- Korniza për siguri dhe rrezistim të bashkësive të aspektit të uljes së rreziqeve nga katastrofat
- Udhëzim praktik për avokativitet dhe ulje të rreziqeve nga katastrofat
- Kornizë e plan/programit për uljen e rreziqeve nga katastrofat
- Si i ulë rreziqet Kryqi i kuq

- Komunikime në[ situata emergjente
- Preventivë në vend të shërimit

## Përmbajtja e doracakut

Me qëllim të ketë ndikim në bazë të uljes së rreziqeve nga katastrofat, në nivel nacional apo lokal, ka nevojë që të ekzistojë qasje sistematike me angazhime dhe aktivitete siç janë përshkruar në *udhëzimin për kujdes shëndetësor dhe ndihmë të parë në bashkësi.* Ky doracak duhet të shërbejë si ndihmë për personat të cilët planifikojnë aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e opinioit në bazë të rreziqeve nga katastrofat.

Doracaku sintetizon më shumë qasje të cilat ndërmerren në lëvizje me qëllim që të sigurohet shqyrtim në bazë të asaj se çka funksionon e çka jo me dëshmi nga studimi aty ku kanë qenë të kapshme. në këtë mënyrë iu ndihmohet shoqatave nacionale të bëjnë zgjedhje të mirë në bazë të qasjeve më adekuate dhe t'i përdorin resurset ekzistuese dhe mjetet për ngritjen e vetëdijes së opinionit në domenin e uljes së rreziqeve nga katastrofat që përdoren nga shoqatat nacionale. Këtu janë prezantuar edhe udhëzime nga studimi për rreziqe gjatë komunikimeve dhe edukimi publik për ndryshim në sjellje si dhe zbulimet e praktiuesve të ndryshëm gjatë zbatimit të të njëjtave.

Doracaku fokusohet në 4 qasje kryesore:

- Fushata
- Mësimi participativ
- Edukimi jo formal
- Intervenime formale të cilat zbatohen në shkolla

Në doracak shqyrtohen mjete për implementimin ekëtyre qasjeve, si dhe publikime, programe mësimore, module dhe prezantime, mësim elektronik, shfaqe dhe vepra kulturore, lojëra dhe gara, materiale audio dhe video, ueb faqe dhe aktivitete, media sociale dhe telekomunikacione.

Doracaku gjithashtu sqaron se si të sigurohet që këto mjete të jenë me kualitet të lartë, me fotografi të mira dhe porosi të përpunuara mirë, të adaptuara dhe të dëshmuara në situatat lokale. Gjithashtu në doracak prezantohen edhe principet që nevojiten për zbatimin e tyre: legjitimitet dhe kredibilitet, vijueshmëri dhe porosi standarde dhe qëndrueshmëri.

Nëpërmjet numrit të madh të shembujve në doracak prezantohen përvoja, qasje dhe mjete nga rajone të ndryshme të botës. Në këtë mënyrë lexuesi ka mundësi që prej së afërmi të njoftohet me shembuj të caktuar dhe drejtpërsëdrejti të bie në kontakt me ekipet të cilat i kanë zbatuar këto aktivitete, përderisa për këtë ka nevojë. Shembujt nuk janë të klasifikuara në krahasim me rezultatet e

realizuara për shkak se lexuesit mund të mësojnë shumë nga përvojat të cilat llogariten për shumë të suksesshme si dhe ato që nuk kanë mundur në tërësi t'i plotësojnë pritjet.

Në kaptinën e fundit në bazë të menaxhimit të diturisë janë paraqitur monitorimi dhe evaluimi, shpërndarja e diturisë dhe mbindërtimi i kapaciteteve – e të gjithë ato luajnë rol të rëndësishëm në dizajnimin dhe implementimin e strategjive të mira.

Programet për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit mundet të fillojnë dhe të jenë thurrura sipas nevojave të popullatës specifike, rreziqeve ekzistuese, dhe grupeve qëllimore. Këto parime mund të integrohen pothuajse në të gjitha iniciativat ekzistuese, pa dallim se ku dhe kur ndodhin. Ato mund të përdoren për mobilizimin e vullnetarëve dhe komunikimit moshatar.

Për këtë qëllim ju nevojiten edhe porosi të nufikuara për uljen e katastrofave dhe informacioneve të qarta dhe të targetuara, edukim dhe materiale për komunikim. Gjatë gjithë doracakut në kube do të gjeni informacione të ndryshme, tabela, shembuj, udhëzime hap pas hapi dhe shembuj praktik dedikuar për paraqitje praktike të teorisë që do t'ju ndihmojnë që atë që keni mësuar ta zbatoni në situatën tuaj.

## Rezime individuale të kaptinave

### 1. Hyrje

Kjo kaptinë sqaron se pse nevojitet ky doracak dhe i numëron resurset në pjesë të caktuara dhe ju sqaron se si janë përgatitur dhe cilat janë përmbajtjet kyçe.

### 2. Planifikim: pyteje të cilat duhet të parashtrohen

Kjo kaptinë jep përgjigje në pyetjet si për shembull: pse?, kush?, çka?, me kënd?, ku?, dhe kur?, si?, me cilat mjete?, dhe çka tjetër?. I identifikon ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e opinionit si intervenime specifike të planifikuara dhe për integrim në aktivitetet e vazhdueshme.

### 3. Katë qasje kyçe

Kjo kaptinë sqaron se si të zbatohen secila prej katër qasjeve – **fushata, mësim participativ, edukim joformal dhe mësim formal në shkollë.** Këtu janë paraqitur spektër i gjërë i aplikacioneve dhe metodave, të cilat sigurojnë ide dhe kahje për planifikim strategjik.

4. **Parime për implementim efektiv**

Kjo kaptinë i paraqet parimet në të cilat prehet korniza straqtegjike dhe qasjet: legjitimiteti dhe kredibiliteti, vijueshmëria, vëllimi dhe qëndrueshmëria. Strategjitë dhe idetë të cilat merren parasysh mund të maten në pajtueshmëri me këto parime gjatë procesit të planifikimit.

5. **Mjete**

Kjo kaptinë përshkruan spektër të gjërë të mjeteve të cilat përdoren për implementimin e këtyre qasjeve, siç janë publikimet, lojërat dhe garat, dhe mediat sociale, dhe i sqaron përparësitë dhe mangësitë të secilit prej tyre.

6. **Sigurimi i kualitetit**

Në këtë kaptinë janë paraqitur pyetjet esenciale të cilat duhet të merren parasysh me qëllim që të sigurohet iniciativat të jenë me kualitet të lartë, të fokusohen në porosi të përpunuara mirë, persona të fuqishëm, të jenë me ton të qetë dhe të adaptohen në konteks lokal.

7. **Menaxhim i diturive**

Në këtë kaptinë janë prezantuar disa prej sfidave të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e diturive. Sigurohen kahje të caktuara fillestare për dizajnimin e interventimeve të ardhshme me qëllim që të përmirësohen proceset, monitorimi dhe evaluimi, ndarja e diturive dhe mbindërtimi i kapaciteteve.

# 2 Planifikim: Pyetje të cilat duhet të parashtrohen

Hapi i parë në përgatitjen e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes apo edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat është që të formohet ekip i vogël, i përkushtuar dhe kreativ për përgatitjen e planit për aksion. Pa dallim se a filloni në nivel nacional, rajonal apo lokal ky udhëzim do t'ju ndihmojë t'i involvoni të tjerët dhe të përgatitni plan të fuqishëm dhe efektiv i cili do ta rrisë besimin dhe kontributin e organizatës.

Ky proces e përcjell ciklin familjar të promovuar në programin për zhvillim në të gjithë lëvizjen. Në rastin e ngritjes sl vetëdijes publike apo edukimit për uljen e rreziqeve nga katastrofat, mënyrë e mirë për të filluar është që të parashtrohen pyetjet në vijim dhe të shqyrtohen përgjigjet.

## Pse është aq e rëndësishme iniciativa?

Lëvizja sheh se vet përgjigjja nuk mjafton për t'u plotësuar nevojat e mëdha të cilat dalin nga rreziqet dhe ndikimet e tyre mbi popullatën e gjërë. Këtu duhet të merren parasysh obligimi për shpërndarjen e diturive që mund t'ju ndihmojë në identifikimin e rreziqeve, ndërmarrje të aksioneve për ndërtimin e sigurisë dhe

rrezistimit, dhe ulje të ndikimeve nga rreziqe që vijnë. Bashkësitë dhe individët zakonisht munden – dhe duan – të jenë partnerë në këtë proces.

Ngritja e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat mund t'i përforcojnë njerëzit normal ku do në botë në bazë të pjesëmarrjes së tyre për uljen e vuajtjeve të ardhshme të mundshme të shkaktuara nga rreziqe dhe katastrofa.

Doracaku për përgjigje dhe planifikim gjatë katastrofave nga Federata ndërkombëtare në vitin 2007, siguron kahje detaje se si të analizohen rreziqet, gjendjet e mjerueshme dhe kapacitetet. Edhe pse është sfidë e madhe të jetë selektiv, ne duhet të fokusohemi në ato rreziqe të cilat mund të ndodhin, si dhe rreziqet të cilat kanë ndikim më të madh mbi numër më të madh të njerëzve. Në disa raste rreziqet të vogla të caktuara të cilat vazhdimisht ndodhin gjithashtu mund të rezultojnë në pasoja serioze negative.

Në disa raste pyetje të caktuara kronike si për shembull ujë i papastërt apo gjendjet e këqija sanitare, janë çështjet kyçe për të cilat duhet të gjendet zgjedhje. Sot, më shumë se gjysma e popullatës në botë, jetojnë në mjedise urbane, dhe ata janë thelbi i jetës ekonomike dhe politike, prandaj në mënyrë sistematike duhet të jemi të gatshëm që këto rreziqe t'i adresojmë në kontekst urban. Situatat komplekse emergjente gjithashtu mund të kenë ndikim në bazë të prioritetit të rreziqeve, për çka nevojitet ndërmarrja e qasjeve sistematike. Në vazhdim, në paraqitjen 1 keni të prezantuar shembull të prioritetizimit të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit. Për këtë qëllim, shqyrtoni secilin rrezik të përmendur në katrorin më poshtë në bazë të mundësisë së tyre relative të ndodhjes dhe pasojave të mundshme. Pastaj futeni secilin rrezik që është relevant në kontekstin tuaj në katrorin adekuat për rreziqe.

Shembuj të rreziqeve:

- Tërmet
- Vërshim
- Zjarr
- Valë e nxehtë
- Thatësira
- Tornado
- Vetëtima
- Vullkan
- Pandemi apo epidemi, si për shembull HIV/SIDA
- Lëshimi i materieve të rrezikshme
- Stuhi dimërore apo ngrirje
- I ftohti ekstrem
- Ortek

- Rrëshqitje e tokës
- Rrjedhje e materialeve nga mbeturinat
- Uragani, cikloni apo tajfuni
- Fatkeqësi transportuese
- Fatkeqësi në komunikacion
- Trazira civile apo konflikte
- Terorizëm apo dhunë
- Mungesë e ushqimit
- Mungesë e rrymës elektrike
- Mungesë e ujit
- Ujë i papastërt apo kushte të këqija sanitare

Përskaj secilit rrezik, ndoshta do të dëshironi të futni numër në bazë të njerëzve të cilët do të ishin të goditur në nivel të caktuar (për shembull, me vdekje, lëndim apo humbje të kulmit mbi kokë, pasurisë apo bashkësisë). Merreni parasysh definicionin klasik për katastrofa që është: “Shkatërrim serioz të funksionimit të bashkësisë apo shoqërisë që rezulton me humbje apo pasoja të mëdha njerëzore, materiale, ekonomike për mjedisin jetësor të cilët e tejkalojnë mundësinë e bashkësisë apo shoqërisë së goditurqë të ballafaqohet me këtë gjendje me resurse të veta personale”.

Gjërat të cilat janë në katrorët me ngjyrë rozë dhe të kuqe duhet të adresohen dhe zgjedhen si më primare.

## Paraqitja 1:Rreziqe

***Mbulimi i fushës gjeografike***

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mundësi | **I lartë** | Shembull:<br>• Fatkeqësi në komunikacion | Shembull:<br>Fatkeqësi në komunikacion | Shembuj:<br>• Tërmete në vende urbane<br>• Zjarre pas tërmeteve<br>• Pirja e duhanit |
| | **I mesëm** | Shembuj:<br>• Fatkeqësi transporti<br>• Mungesë e | • Shembuj:<br>• Mot i keq dimëror i madh | Shembuj:<br>• Mungesë uji<br>• Vërshime me mjedise |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | rrymës | • Valë e nxehtë | urbane |
| | I ulët | | Shembuj:<br>• Tornado | |
| | | I ulët | I mesëm | I lartë |
| | Ndikim | | | |

Nga shembujt e përmendur të rreziqeve të paraqitura më lartë, mund të shohimse tërmetet, zjarret pas tërmetit apo pirja e duhanit janë tre pjesët kyqe ku duhet të përkushtohet vëmendja.

## Për cilin dedikohet kjo iniciativë?

Publiku qëllimor për ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e opinionit është drejtuar për shumë kategori. Para se gjithash kategoria kyçe janë njerëzit të cilët duhet të ndërmarrin aktivitete dhe të përkushtojnë vëmendje në bazë të sigurimit të rrethit më të sigurt dhe më rrezistues. Para se gjithash këtu mendojmë tek të punësuarit dhe vullnetarët e Kryqit të kuq.

Menjëherë pas kësaj vijon kategoria e njerëzve të cilët mendojnë për të verpuar por iu nevojiten informacione shtesë dhe besim më i madh me qëllim që të ndërmerren aktivitete adekuate. Kategoria në vijim janë njerëzit të cilët kanë dëgjuar për aktivitetet tuaja dhe fillojnë të mendojnë për këtë çështje. Pastaj vijon grupi i madh i njerëzve që tregon rrezistim ndaj ndërmarrjes së aktiviteteve. Në këtë kategori njerëzit janë më pak të vetëdijshëm për këtë çështje por prapë se prapë nuk kanë për qëllim të ndërmarrin diçka rreth kësaj. Shpesh herë qushen “fatalistë”.

Në fund, ka edhe shumë njerëz të cilët aspak nuk kanë dëgjuar për këto rreziqe, por as që kanë menduar se çka të bëjnë rreth tyre. Edukimi i opinionit dhe ngritja e vetëdijes duhet të përkushtojnë vëmendje të posaçmenë këtë kategori të njerëzve, me qëllim që të bëhen pjesë aktive e kulturës së sigurisë.

Në fakt mund të thuhet se nuk ekziston një “popullsi e përgjithshme”. Në vend të kësaj ka kategori të ndryshme të publikut dhe në të gjithë ata ndikojnë një spektër i ghjërë i dinamikave dhe mjerueshmërive sociale dhe kulturore. Që herët në procesin e planifikimit, është me rëndësi të vendosni se cili prej segmenteve të ndryshme në tregun publik do t’i përfshini me iniciativën tuaj. Bile edhe këto qasje të cilat kanë për qëllim të përfshijnë publikun më të gjërë, duhet të fokusohen në rrethin më të ngushtë të segmenteve në treg.

## Udhëzim hap pas hapi: njoftim me segmentet e tregut

**Hapi 1:** Numrëoni të gjitha grupet qëllimore në të cilat mund të kujtoheni, dhe gjithashtu numëroni edhe nën kategoritë. Për shembull, merrni parasysh:

- Lokacionin gjeografik (lagjet urbane, fshatrat, pjesët më të largëta, periferitë)
- Përfaqësimin gjinor
- Moshën
- Nivelin e arsimimit
- Gjuhën dhe grupin etnik
- Llojin e vendit të punës

Përfshini edhe njerëzit me hendikep, emigrantët, personat e shpërngulur apo të pa strehurit, analfabetët, fëmijët në rrugë, të miturit të cilët punojnë dhe identifikoni mënyrat e posaçmese si të arrihet në këto pjesë të margjinalizuara të publikut tuaj qëllimor.

**Hapi 2:** Numëroni llojet e organizatave, asociacioneve dhe grupeve ku marrin pjesë njerëzit. Këtu nënkuptohen edhe organizatat lokale, organizatat e punës, shkollat, vendet për lutje, asociacionet profesionale, klubet dhe ekipet, bandat lokale,etj.

**Hapi 3:** Shifni se në cilën mënyrë komunikojnë njerëzit në kuadër të rrjeteve personale sociale. Diskutoni dhe numëroni mundësitë dhe pengesat në bazë të secilës prej tyre. Këto të dhënat do t'ju ndihmojnë që më vonë të zgjedhni qasje dhe mjete adekuate të cilat bashkveprojnë në segmentet e ndryshme të publikut tuaj qëllimor.

## Prej çka mund të përbëhet iniciativa

Ngritja e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat ka për qëllim ta përdorë diturinë e kapshme të njeriut dhe të bartet në mjediset lokale me qëllim që të ulen rreziqet nga katastrofat. Ata kanë për qëllim t'i mobilizojnë njerëzit nëpërmjet porosive të qarta, përkrahur me informacione detale.

Vetëdijshmëria për rreziqet vet vetiu na çon drejtë që njerëzit të miratojnë masa për uljen e rreziqeve. Studiuesit kanë zbuluar se njerëzit ndërmarrin aksione vetëm kur:

- Dijnë se cilat aksione specifike mund të ndërmerren për uljen e rreziqeve të tyre.
- Janë të bindur se këto aktivitete do të jenë efektive.
- Besojnë në aftësitë e tyre t'i zbatojnë detyrat e nevojshme.
-

Udhëzimet në studimet munet dukshëm të ndihmojnë në dizajnimin në edukimin e suksesshëm të opinionit. Për shembull, faktet në vijim janë të vërtetuara:

- Njerëzit duhet të stimulohen të kërkojnë informacione.
- Njerëzit kërkojnë koncenzus dhe duan validimin e informacioneve prej më shumë burimeve (për shembull, nga miq, persona profesionistë, pushtete, liderë të respektuar në bashkësi, radio, televizion dhe ueb faqe) para se të ndërmerren veprimtari të caktuara.
- Njerëzit janë të gatshëm të bëjnë diçka që mendojnë se është e drejtë dhe e bëjnë të tjerët (kjo do të thotë se me rëndësi është që vëmendja të fokusohet në të gjitha shembujt pozitiv dhe lokal: kërcënimet negative nuk janë shumë nga ndihma).
- Mësimet të cilat më së miri mbahen mend mësohen nga tregime të cilat janë të thjeshta, të pa pritura, konkrete, të besueshme dhe emotive.
- Procesi gradual i ndrrimit të sjelljes luan prej lindjes së idesë deri në planifikim, aksion dhe në fund vazhdimësi.

Më së miri është të fillohet me gjëra të vogla të lehta që do të bëjnë ndryshim pozitiv, që t'ju ndihmohet njerëzve të shijojnë, dokumentojnë dhe ndajnë sukses të caktuar. Është shumë me rëndësi të ndërmerren masa të caktuara fizike dhe ekologjike që ulin rrezik të caktuar – për shembull, përforcimi i mobiljeve që të mos luajë gjatë tërmeteve, apo pastrimit të kanaleve për ndalimin e vërshimeve.

Ngjajshëm me këtë, ndihma e parë nuk mund të ndihmojë nëse nuk janë të hapura qendrat shëndetësore për sigurimin e mbrojtjes primare shëndetësore, për shkak se nuk kanë mundur të ndërmarrin masa për ulje fizike të rreziqeve si rezultat i erërave dhe dridhjeve të forta të tokës.

Njerëzit të cilët janë të shfaqur në rrezik nga përmbytjet, era dhe tërmeti, duhet të mësojnë gjëra elementare në bazë të ndërtimeve të cilat janë të qëndrueshme në katastrofa, nëse masat për ulje (lehtësim) obligojnë ekspertizë e cila nuk është e kapshme atëherë është kohë e duhur që të sigurohet.

Kërcim i drejtpërdrejtë nga ngritja e vetëdijes nga rreziqet kah aftësitë për përgjigje dhe përgatitshmëri gjatë katastrofave mund të tregojë se katastrofat janë të pa shmangshme, dhe se e vetmja gjë që mund ta bëjnë njerëzit është të reagojnë pasi të ndodhin katastrofat. Kjo çon kah sjellja fatalistike.

## Me cilin duhet të punojmë?

Partneritetet janë shumë të rëndësishme për realizimin e susksesit në fushën e edukimit publik dhe ngritjen e vetëdijes. Strategjitë e mira dalin nga bashkëpunimet e suksesshme, ndërsa bashkëpunimi është thelbësor për përgatitjen e porosive të harmonizuara dhe të standardizuara që do të mbindërtohen dhe përsëriten aq shpesh deri sa të bëhen rutinë e përditshme. Partneritetet e qëndrueshme në përgjithësi janë vendim për investim në

ndërtimin e marëdhënieve në periudhë më të gjatë kohore. Shumë palë të interesuarajanë të gatshme për partneriteteme shoqatat nacionale, por prapë se prapë procesi reciprok për njohje më të mirë mes veti, zhvillim i besimit dhe kontributi i resurseve, obligon përkushtim afatgjatë.

Nëse filloni me pak, mundet së bashku të rritni prej një suksesi kah tjetri. Një prej programeve për dhënien e përkrahjes pas ndodhjes së katastrofave ku ishin kyçur të punësuar të cilët vepruan në disa nsektore të posaçme, zbuluan se ekipi është më efektiv kur anëtarët punojnë në partneritet në plotësimin e nevojave të caktuara në pjesën e dhënë gjeografike.

## Lista e kontrollimit: kyçja e grupeve të margjinalizuara

- Shifni se cila periudhë kohore apo lokacion janë më adekuate për mbajtjen e takimeve me burra dhe gra. A do të ndihmojë përderisa sigurohen kujdestare për fëmijë?
- A duhet mbledhjet të mbahen në gjuhë të ndryshme dhe nëse është ashtu a ka nevojë për përkthyes?
- Merrni parasysh vizitën e njerëzve prej dere në derë dhe prej rruge në rrugë.
- Kujdesuni që në aktivitete të kyçen edhe fëmijë edhe të rinj të moshës adekuate.
- Siguroni interpretues të gjuhës me shenja për njerëzit e shurdhër.
- Mbledhjet mbani në lokacione ku do të kenë qasje dhe persona të palëvizshëm të cilët lëvizin në karroca.
- Siguroni material informativ të shtypur në të gjitha gjuhët e patjetërsueshme.
- Kujdesuni që materialin audio dhe vizuel t'i bartin porositë pa e pasur patjetër njerëzit të lexojnë.
- Përdorni radio porosi që të mund të arrijnë në lokacionet më të largëta dhe sociale të izoluara.
- Kujdesuni që shënimet e video materialeve të jenë në më shumë gjuhë, varësisht nga nevojat.
- Kujdesuni që ueb faqet të përmbajnë materiale të shkruara dhe të përkthyera.

Mbani mend se shoqatat nacionale nuk është patjetër të jenë agjencion udhëheqës për secilin aktivitet. Thjesht bëhuni pjesëmarrës dhe kontribuoni me

punën dhe kredibilitetin tuaj dhe me atë që do të luani rol të rëndësishëm në përfitimin e përkrahjes publike për realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Udhëheqja juaj, apo prania juaj është përfaqësues i fuqishëm për realizimin e qëllimit të caktuar.

Dhe përfundimisht, partnerët tuaj kyç janë edhe përdoruesit tuaj qëllimor. Kyçni këta individë në procesin e përgatitjes së metodave dhe qasjeve, si dhe në revidimin e programeve dhe materialeve. Në Tabela 1 më poshtë janë paraqitur një numër i caktuar i vepruesve të cilët mund të jenë partnerë (nga ana e majtë) si dhe shembuj të roleve dhe përgjegjësi për sigurimin e përkrahjes (nga ana e djathtë).

**Tabela 1: Partneritet**

| Kush? | Pse? |
|---|---|
| Ne: vullnetarë, të rinj dhe të punësuar të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe | Të jepet shembull, dhe të përjetohen dhe zgjedhen probleme reale nga jeta. |
| Qeveri: Posaçërisht platforma nacionale për uljen e rreziqeve nga katastrofat, dhe të gjitha ministritë relevante, agjenci apo njësi. | Të sigurohen sanksione dhe përkrahje, të ndërtohet koncenzus, të përgatiten porosi standarde, dhe të angazhohen dhe të arrihet deri tek sa më shumë njerëz që mundet. |
| Vetqeverisje lokale: këshilla dhe agjencione komunale dhe rajonale. | Të sigurohen skanskione dhe përkrahje, që të mbindërtohen kapacitete dhe të rriten dhe të institucionalizohen orvatjet. |
| Bashkësi lokale, fshatra dhe lagje urbane: pjesë ku jetojnë dhe punojnë vullnetarët e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. | Të sigurohet që orvatjet të provohen dhe testohen dhe të rrënjosen në bashkësi lokale. Përdoruesit bëhen vullnetarë potencial. |
| Publiku qëllimor: Përfaqësues të zgjedhur nga të gjitha segmentet e popullatës qëllimore. | Të nxitet dialogu me qëllim që të sigurohet shqyrtim dhe informacione kthyese në procesin e përgatitjes së programeve dhe revidimin dhe testimin e programeve. |
| Qeveri: spektër i gjërë i agjencioneve dhe njësive në të gjitha nivelet e pushteteve, kyçur edhe shërbimet e shëndetësisë, arsdimit, situatave në krizë, mjedisit dhe planifikimit jetësor. | Të zhvillohet roli ndihmës i Lëvizjes në raport me pushtete, me qëllim të përgatitet teren për partneritete të ngushta në fushën e edukimit opinionit për uljen e katastrofave. |

| Kush? | Pse? |
|---|---|
| Ekspertë shkencor dhe teknik dhe ekspertë për dituri lokale: njerëz të cilët mund të sigurojnë ekspertizë në tema me diciplinë të ndryshme, kyçur edhe shkencat fizike dhe ingjinieri, shëndetësi, arsim, marketing, dizajnim, komunikime. | Të bëhet vlerësimi i burimeve potenciale të diturive dhe përvbojave, me qëllim që të forohen dhe validohen porosi dhe kahje. Këbmimi i diturive teknike dhe lokale këtë e transformojnë në informacione adekuate, dhe janë me rëndësi thelbësore për realizimin e përparimit në fushën e uljes së rreziqeve. |
| Sektori qytetar: të gjitha organizatat me qëllime të ngjashme dhe që punojnë në pjesë konkrete gjeografike. Ato mund të jenë organizata joqeveritare, organizata profesionale dhe tregtare, shkolla, mësimdhënës dhe prindër. | Të sigurohet përkrahje e mënyrave të ndryshme. Bashkëpunimi është më efektiv se sa garimi me të tjerët. Disa prej këtyre partnerëve do të veprojnë si urë e rëndësishme ndaj segmenteve të ndryshme të popullatës tuaj qëllimore. Disa partneritete mund të jenë zyrtare dhe formale, përderisa tjerat mund të jenë të thjeshta dhe joformale. |
| Sektori privat: korporata të mëdha, kyçur kompani komunale dhe të sigurimit, media, ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrës individual. | Ndihmë që të arrihet në publikun e gjërë me porosi të qarta dhe të thjeshta. Përgjegjësia korporative shoqërore mund të dizajnohet në mënyrë që për partnerët do të jetë e dobishme në mënyrë reciproke. Përkrahja e përforcon kredibilitetin. |
| Fëmijë dhe të rinj: fëmijë të rinj dhe rini të cilët duhet të hasin dituri për preventivë nga katastrofat. | Për promovimin e shëndetit dhe mirëqenies, për zhvillimin e vetbesimit dhe aftësive, për sigurimin e politikave dhe shërbimeve që të përmirësohen si investicion për ardhmëri më të mirë. Fëmijët e rinj janë më efektiv në raportet me moshatarët e tyre. |
| Partnerë ndërkombëtar: veprues dhe biznese qeveritare, mes – qeveritare dhe joqeveritare | Për qasje, këmbim dhe mbindërtim të bashkëpunimit tej – kufirit. |
| Donatorë: qeveritarë, joqeveritarë, privat dheorganizata qytetare e individë. | Sa më shumë që donatorët e kuptojnë dhe e çmojnë punën me ju, aq më e madhe është mundësia për bashkëpunim afatgjatë dhe qëndrueshmëri të aktiviteteve në fushën e edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat. |

## Kur dhe ku iniciativa është adekuate?

Shoqatat nacionale janë të involvuara në spektër të gjërë të aktiviteteve, ndërsa shumica e tyre ofrojnë mundësi për integrimin e ngritjes së vetëdijes së dhe edukimin e opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Planifikimi strategjik mund të ndihmojë të përdoren këto aspekte, dhe të identifikohen mundësi të caktuara për ngritjen e çështjes së edukimit dhe vetëdijes së opinionitsi çështje kryesore me qëllim që të arrihet në pjesët dhe bashkësitë[ më të rrezikuara.

Të thurrura së bashku, aktivitetet e Lëvizjes kontribuojnë për bashkësi më të sigurta dhe më rezistuese dhe kontribuojnë në mbindërtimin e procesit për zhvillim të qëndrueshëm. Ngritja e vetëdijes dhe edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat duhet të luajnë rol kyç në këtë proces në të ardhmen. Shumë prej këtyre masave të cilat promovojnë strehim të sigurt, ujë të pastërt, sanitacion dhe higjienë, shëndet, mbrojtje të mjedisit jetësor, të cilat janë kyçe në bazë të uljes së rreziqeve nga katastrofat. Duhet të akumulohet e gjithë ekspertiza teknike e këtyre sektoreve së bashku me treguesit plotësues që dalin nga vlerësimi i rreziqeve nga rreziqet dhe masat specifike për lehtësimin e rreziqeve dhe zgjidhje të problemeve diciplinare.

Në Tabela 2 më poshtë, janë paraqitur shumë mundësi për integrimin e edukimit të opinionit dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat.

### Tabela 2: integrimi i edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat

| Aktivitete kyç | Aktivitete të përkrahura me edukimin e opinionit |
|---|---|
| **Vlerësim dhe planifikim** | |
| Vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve | • Edintifikimi i rreziqeve<br>• Vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve<br>• Hartimi i rreziqeve, mjerueshmërive dhe resurseve |
| Planifikim dhe avokativitet | • Planifikim për përgatitje gjatë katastrofave në bashkësinë lokale<br>• Planifikim i integruar në bashkësi<br>• Planifikim për përgatitshmëri të familjes gjatë katastrofave<br>• Planifikim për përdorim të sigurt të truallit<br>• Planifikim të vazhdimit në biznes<br>• Planifikimi i vazhdimit në arsim<br>• Përfaqësim ligjor<br>• Planifikim i sigurimit |
| Sisteme për paralajmërim të | • Funksionim i sistemeve për paralajmërim<br>• Formulim, dorëzim dhe verifikim të porosive për |

| | |
|---|---|
| hershëm | paralajmërim të hershëm.<br>• Planifikim të evakuimit |
| **Sigurim fizik dhe ekologjik** | |
| Siguri strukturore dhe jo strukturore | • Praksa për përdorim të sigurt të truallit<br>• Ndrëtim i ndërtimeve rrezistuese në katastrofa (shtëpi, shkolla, qendra shëndetësore)<br>• Modernizimi i ndërtimeve ekzistuese<br>• Ndërtim dhe mirëmbajtje të strehimoreve të sigurta<br>• Përforcim i mobiljeve të larta për mure që të sigurohet gjatë tërmetit<br>• Përforcim i pajisjes dhe materialeve tjera që të sigurohet stabilitet gjatë tërmetit<br>• Hapje e dyerve nga jashtë<br>• Ushqimi dhe materialet tjera të ruhen mbi nivelin e përmbytjes së mudshme |
| Siguri në infrastrukturë, kyçur edhe ujë e sanitacion | • Planifikim të rrugicave për evakuim<br>• Mënjanim i mbeturinave të forta<br>• Pastrim i kanaleve derdhëse<br>• Sigurim i terenit nga rrëshqitja e dheut<br>• Sigurim i ujit për pije dhe trajtimi i tij.<br>• Ruajtja e ujit (kyçur edhe mbledhës të shiut për ujitje, ndërtim të pendave dhe kanaleve)<br>• Pastrim të shtartit të lumit<br>• Vendosje të nevojtoreve recikluese<br>• Ruajtje e energjisë<br>• Përdorim i energjisë së pastërt dhe ripërtrirëse për nxemje, gatim dhe ndriqim (energji solare, erë dhe pompa uji |
| Siguri në ushqim dhe mbrojtje e pasurisë | • Përtrirje e tokës në këneta dhe bregut<br>• Mbjellje e pyjeve<br>• Përtrirje e biodiverzitetit<br>• Zgjedhje e kullosave për adaptim në periudhat e thatësirave<br>• Kopshte në shkolla dhe shtëpi<br>• Trajnim profesional |
| Shënbdet | • Promovim i higjienës dhe sanitacion<br>• Vëzhgimi i shëndetit në mjedisin jetësor<br>• Ngritja e vetëdijes për mbrojtje nga sëmundjet të cilat barten nëpërmjet ajrit dhe ujit<br>• Rrjete për mbrojtje nga mushkonjat<br>• Mbrojtje dhe trajtime nga malaria<br>• Edukim për shëndet oral<br>• Shpërndarja e prezervativëve |

| Përgatitshmëri, përgjigje dhe rimëkëmbje nga katastrofat | |
|---|---|
| Aftësi për përgatitje gjatë katastrofave, përkrahje psiko – sociale dhe ndihma e parë në bashkësi | • Trajnime dhe simulime<br>• Respektim të rregullores për paralajmërim të hershëm dhe evakuim<br>• Organizim të përgjigjes adekuate në katastrofa<br>• Kërkim dhe shpëtim<br>• Aftësi për ndihmë të parë<br>• Kalsifikim gjatë numrit masiv të të lënduarve<br>• Ndihmë e parë psikologjike<br>• Mësim të aftësive për jetësim dhe zgjidhje të konflikteve<br>• Orë për notim<br>• Komunikim ajror |
| Sigurim i përgjigjes gjatë katastrofave | • Sigurim i ujit dhe ushqimit dhe ndarja e tyre<br>• Sigurim i materialeve për ndihmë të parë (pajisje standrade për ndihmë të parë)<br>• Jelekë për shpëtim dhe objekte lundruese<br>• Pajisje për komunikim gjatë situatave emergjente<br>• Mallëra që përdoren gjatë situatave emergjente |

## Në cilën mënyrë do t'i prijmë iniciativës?

Në këtë udhëzim janë vërtetuar mënyrat kyçe se si t'i prihet në bazë të ngritjes së vetëdijes apo edukimit të opinionit me qëllim që të ulen rreziqet nga katastrofat. Në Kpatina 3 janë përfaqësuar 4 tipe kryesore të qasjeve të cilat mund të përdoren:

- Fushata
- Mësim participativ
- Arsimim jo formal
- Intervenime formale shkollore

Këto qasje nuk janë të ndara. Idea është që të gjendet zgjedhje më adekuate që do të përgjigjet në qëllimet, publiku qëllimor, dhe mundësitë dhe resurset të cilat janë në disponim. Programet e suksesshme mund të përdorin shumë qasje dhe mjete për bartjen e porosisë me qëllim që të sigurohet ndikim maksimal.

Ekzistojnë 3 parime të rëndësishme të cilat i drejtojnë këto orvatje (shiko Kaptina 4):

- Vijueshmëri dhe porosi standarde
- Legjitimitet dhe kredibilitet

- Vëllimi
- Qëndrueshmëri

Të gjitha rubrikat standarde profesionale për planifikim programor zbatohen në këtë proces;mes cilave:

- Nevojë për identifikimin e treguesve
- Nevoja të vullnetarëve dhe të punësuarve
- Resurse të nevojshme
- Përshrkim detal i metodologjisë për implementim
- Monitorim dhe evaluim

Gjëra plotësuese të cilat duhet të merren parasysh janë:

- Mësime të mësuara nga e kaluara – në nivel lokal dhe global
- Udhëzime nga vëzhgimi për praksa të mira në bazë të komunikimeve gjatë rreziqeve, marketing social dhe tradita publike dhe shëndetësore.
- Mundësi për fillimin e iniciativës në rrethin e vet

## Cilat mjete duhet t'i përdorim?

Pasi të zgjedhet qasja, hapi në vijim është që të zgjedhen mjete adekuate për dërgimin e porosive. Në Kaptina 5 përshkruhen më shumë mundësi, mes cilave edhe publikime, module për trajnim dhe prezantime, plani mësimor për e-mësim, materiale nga programet formale mësimore, ngjarje artistike, lojëra dhe gara, audio dhe video materiale, ueb faqe dhe aktivitete, media dhe telekomunikacione sociale.

Ato mund të jenë të ndara në 3 lloje të ndryshme të kontakteve:

- Dërgim njëkahësh të porosive (prej 1 burimi deri në publikun e gjërë)
- Interaksion dykahësh (sy më sy)
- Interaksion të më shumë personave me më shumë persona (rrjete sociale nëpërmjet përdorimit të telefonit dhe internet mjeteve).

Dëshmitë tregojnë se më së miri është të përdoret kombinim i këtyre llojeve të kontakteve si përkrahje e procesit vijues për ndryshim në sjellje. Me vet ballafaqimin e njerëzve me informacionet, është e qartë se rrjetet sociale vazhdojnë të luajnë rol thelbësor në fushën e mësimit social.

Zgjedhja juaj e mjeteve do të varet nga publiku qëllimor, qasjet dhe resurset e kapshme. Kualiteti i atyre mjeteve në masë të madhe do të kontribuojë se sa mi rë do të përpunohen porositë, sa të fuqishëm do të jenë personazhet, si do të

jetë aftësia e publikut në pajtueshmëri me dëshmitë sociale për vlerën e tyre dhe në cilën mënyrë do të mund të adaptohen dhe lokalizohen porositë. Në këtë proces është shumë me rëndësi ashtu të realizohet bashkëpunimi edhe me firma profesionale reklamuese, dhe universitete lokale për dizjane dhe komunikime me qëllim që prodhimet të jenë në nivel të lakmueshëm.

Për përmirësimin e kualitetit të këtyre mjeteve, shiko në Kaptina 6.

## Çka duhet tjetër të kemi parasysh?

Ndikimi i pritur nga ngritja e vetëdijes së opinionit dhe edukimit të opinionit për uljen e katastrofave janë të lidhura drejtpërdrejtë me rezultatet e pritura nga Strategjia 2020. Dëshmia më e mirë për sukses është në formë të katastrofave potenciale të cilat mund të tejkalohen. Kjo do të thotë se ngjarjet e vërteta në të ardhmen (të cilat ndodhin menjëherë apo të cilat fillojnë ngadalë), do të paraqesin testimin e përgatitshmërisë.

Megjithatë, në ndërkohë na nevojiten dëshmi të cilat do tna ndihmojnë t'i gjejmë mjetet më efektive për edukim dhe mobilizim për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Evaluimi sistematik është me rëndësi esenciale për zhvillimin e kulturës së preventivës dhe ndarjes së diturisë, që të sigurohet kualitet dhe mbindërtim i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë.

Në pikëpamje historike, rezultatet dhe treguesit në bazë të vetëdijes publike dhe edukimit maten ose nëpërmjet numrit të aktiviteteve (për shembull, numri i pjesëmarrësve në trajnime ose numri i kopjeve të shtojcave të botuara), apo dituria e hasur. Megjithatë, mënyrë larg e sigurt për vlerësimin e ndikimit është që të maten treguesit e ndryshimit të sjelljes që kanë të bëjnë me rrezistencë, përgatitshmëri, veprim, masa për uljen e rreziqeve dhe aktiviteteve për avokativitet.

Monitorimi është me rëndësi esenciale, për shkak se ju mundëson t'i përmirësoni dhe përshtatni qasjet dhe mjetet gjatë projektit. Qasjet dhe mjetet vazhdimisht ndryshohen prandaj është e nevojshme që ato të evaluohen për shkak se përfitimet dhe mangësitë mund të jenë mësim i rëndësishëm për në të ardhmen. Megjithatë, mësimet e dokumentuara mund të bëhen mësime të mësuara vetëm kur të bëhen pjesë e memorisë institucionale. Për të ndodhë kjo, është e nevojshme të ekzistojë menaxhim sistematik i diturive, në lëvizje, në rajonet dhe në shoqatat nacionale.

Sidat që kanë të bëjnë me shpërndarjen e informacioneve dhe mbindërtimin e kapaciteteve janë të lidhura me dallimet gjuhësore, barierat kulturore dhe qasjen e ndryshme në infrastrukturën e komunikimit. Qendra rajonale dhe ndërkombëtare për referim luajnë rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve, filtrimi i tyre, vërtetimi i kualitetit dhe mbindërtimi i kapaciteteve. Kaptina 7 shqyrton një pjesë të këtyre mjeteve dhe ka për qëllim të nxisë diskutim në bazë të mënyrave për vazhdimin e përmirësimit të ndarjes së

diturive dhe zhvillimin e kapaciteteve, përdorim dhe optimalizim të mjeteve nga era digjitale.

## Katër qasje kyçe

Në këtë kaptinë janë paraqitur 4 tipe kryesore të cilat mund të përdoren për vetëdije publike apo edukim publik për uljen e rreziqeve nga katastrofat:

- **Fushata**
- **Mësim participues**
- **Arsimim joformal**
- **Intervenime formale shkollore**

Për secilën nga këto qasje në doracak janë siguruar informacione elementare, mjete të dobishme (lista për kontrollim dhe formate), përparësi dhe mangësi për secilën nga qasjet dhe mjetet të cilat mund të përdoren me secilën qasje.

## Qasja 1: Fushata

Qëllimi i fushatave është që të sigurohet ndikim universal, vëllimor me porosi standarde. Ekzistojnë shumë shembuj për fushata të mëdha nacionale dhe ndërkombëtare për ngritjen e vetëdijes së opinionit që kanë sjellur në ndryshime të mëdha sociale. Shembull për këtë janë, fushatat për vaksinimin e fëmijëve, lidhja me rrypa siugurimi në automjete, dhe kufizimi i pirjes së duhanit.

Fushatat përbëhen prej më shumë aktiviteteve, mes cilave:

- Publikime, bilborde, postere, faqe kryesore në gazeta apo revista, kartela informative, fletushka, bukmarkerë dhe broshura.
- Programe mësimore, module dhe prezantime PowerPoint dhe prezantime orale.
- E-mësim
- Pika artistike dhe ngjarje kutlurore
- Lojëra dhe gara
- Audio dhe video materiale
- Internet faqe dhe aktivitete
- Media sociale dhe telekomunikacione

Këto aktivitetemund të ndahen në komponente kyçe dhe variacione në secilën prej këtyre qasjeve siq është paraqitur në Tabela 3.

## Tabela 3: Komponente kyçe të fushatave dhe variacioneve

| Komponente kyçe | Variacione | | |
|---|---|---|---|
| Porosi | • Një apo më shumë porosi | • Së bashku apo veçmas | |
| Publika | • Nivel nacional | • Nivel rajonal | • Nivel lokal |
| Strategjia | • Promovimi i strategjisë<br>• Ditë për shënim, si për shembull përvjetor<br>• Ditë apo javë për përgatitshmëri gjatë katastrofave<br>• Dita e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe apo java e Kryqit të kuq<br>• Dita ndërkombëtare për uljen e katastrofave (në Tetor)<br>• Ngjarje javore apo mujore apo aktivitete<br>• Shpërblime apo gara<br>Trajnime treguese | | |
| Koha | • Gjatësia: afatshkurtë apo afatgjatë<br>• Kohëzgjatja: gjithë viti apo sezonë<br>Frekuenca: një herë pao disa herë | | |

Skema e zakonshme është që shoqatat nacionale të jenë bartës të aktiviteteve dhe ta përdorin entuziazmin e vet dhe energjinë që t'i bindin të tjerët që të kyçen. Gradualisht me rritjen e përkrahjes publike dhe kontributin vullnetar do të jetë më lehtë të sigurohet përkrahja e publikut për implementimin e aktiviteteve të dëshiruara. Sjellja e rregullave dhe mjetet stimuluese mund të ndihmojë të kyçen edhe persona plotësues. Përfundimisht do të ketë edhe të tillë të cilët tregojnë rrezistencë deri sa nuk sjellen dënime të caktuara.

Fushatat më të suksesshme obligojnë përdorimin e porosive të përhershme përsëritëse dhe vijuese tematike që përsëriten në periudhë më të gjatë kohore nëpërmjet aktiviteteve në sektorin publik, privat, qytetar dhe arsimor. Disa prej tyre paraqiten në sezonë të caktuar apo kohë vjetore (për shembull, gjatë sezonit të uraganeve). Tjerat zhvillohen vazhdimisht dhe zgjedhet nën – temë vjetore ndryshuese, dhe përgatitet kalendar mujor me 10 deri 12 porosi në vit.

Fushatat më të fuqishme dhe më të kujtuara bëhen rreth 1 sllogan dhe i vetëm i përhershëm, i shprehur në mënyrë kreative.

Shembull i mirë për këtë është fushata për siguri në komunikacion në Britaninë e Madhe në vitin 1971 (“klik kllak udhëtim i sigurtë”). Ky sllogan ishte esenca e fushatës në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1971, dhe paraqiste hyrje në bartjen e obligueshme të rrypave të sigurimit sjellur me ligj në vitin 1983. Disa fushata kanë maskota të cilat mbahen mend gjatë. Në Shtetet e Nashkuara të Amerikës, arusha Smouki u paraqit së bashkiu me slloganin “Vetëm Ti mund t’i ndalosh zjarret në pyje” prej vit6it 1944. Edhe sot e kësaj dite pothuajse 95% e të rriturve dhe 77% e fëmijëvfe në Amerikë e njohin arushin dhe porosinë e tij. Aty ku fushatat janë afatshkurte dhe të kufizuara me kohë për shkak se me sukses i kanë lënë qëllimet (sikur te fushata për çrrënjosjen e lisë), mjetet e përgatitura më vonë mund të adaptohen dhe të përdoren në kohë apo vend tjetër, kur ka nevojë për intervenim të ngjajshëm.

Për shkak se për fushatat nevojitet që të jenë vazhdimisht në lajme dhe të kenë vizibilitet të madh, shpesh herë ato fokusohen rreth ditëve të caktuara gjatë vitit kur shënohen ngjarje, apo gjatë kohës së trajnimit të caktuar, festivalit, panairit apo ekspozitës apo zbatohen së bashku me trajnime dhe simulime të caktuara treguese. Gjatë kohës së këtyre ngjarjeve kryesore, vullnetarët i bartin porositë kyçe nëpërmjet komunikimeve me të pranishmit. Kjo mund të realizohet në më shumë mënyra, për shembull:

- Në tubime në shkolla apo pas mbarimit të orëve të mësimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të caktuara;
- Në tezga të vendosura në treg;
- Në ngjarje kulturore apo shfaqe të caktuara artistike;
- Gjatë vizitave në lokalitete të caktuara.

Përskaj aktiviteteve të vullnetarëve të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, fushatat mund të përkrahen edhe nga ana e organizatave të ndryshme të bashkësisë, organizata për kamping, mbrojtje civile, grupe studentore dhe shoqata tjera profesionale apo joqeveritare. Shpesh herë fushatat janë mënyrë e shkëlqyeshme për mësimin e qasjeve participuese. Përdoreni formën më të thjeshtë për planifikimin e fushatës të paraqitur më poshtë për planifikimin e aktiviteteve.

## Paraqitja 2: Formati për planifikimin e fushatës

### Kontrollimi i elementeve për planifikimin e fushatës

Emri i fushatës:
Koordinatorë:
Kohëzgjatja:
Rezime e shkurtë:
Qëllimi kryesor dhe qëllime specifike:
Porosi të fushatave:
Publikime qëllimore:
Straetegji komunikimi:
Partnerë dhe përgjegjësi:
Buxhet dhe kontribute në mallëra:
Përparësitë dhe sfidat e fushatave janë paraqitur më poshtë në Tabela 4

## Tabela 4: Përparësi dhe sfida gjatë zbatimit të fushatës

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Përfshirja e një numri të madh të njerëzve me porosi standarde<br>• Tërheqja e vëmendjes së mediave<br>• Mbindërtimi i anëve të fuqishme të të gjithë partnerëve | • Patjetër duhet me kujdes të planifikohet dhe mendohet<br>• Nevojitet organizim i mirë<br>• Nevojitet përkrahje e fuqishme nga partnerët<br>• Nevojitet këmbëngulje: fushatat nuk duhet të mbarojnë deri sa nuk arrijnë sukses |

Pasi të zgjedhet qasja adekuate për fushatën, kalojmë në qasjen 2: mësim participues.

## Qasja 2: Mësim participues

Njerëzit posaçërisht janë të motivuar nga qasje në të cilat ata vetë marrin pjesë në gjetjen e zgjidhjeve, posaçërsiht kur besojnë se ajo është ide e tyre personale. Fokusi i mësimit participativ është që të angazhohen njerëz në zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve lidhur me çështjen e uljes së rreziqeve në katastrofa. Thelbi i të gjitha këtyre aktiviteteve është përdorimi i përvojave personale të bashkësisë.

Këtu nënkuptojmë përdorimin e gjuhës, tregimeve, këngëve dhe traditave për përforcimin e kulturës së preventivës. Kjo posaçërisht mund të arrihet nëpërmjet mjeteve siç janë:

- Studimi siç është për shembull vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve
- Planifikimi i menaxhimit të katastrofave
- Implementimi i porosive për uljen e rreziqeve
- Monitorim dhe përmirësim i planeve nëpërmjet trajnimeve dhe simulimeve

Këto 4 elemente të mësimit participues mund të zbatohen në 3 nivele:

- Niveli organizativ – zyra qendrore, organizata komunale e Kryqit të kuq, shkolla,ndërmarrje, shtëpi
- Në nivel të bashkësisë – vëllimi që të mundësohet involvimi i fshatrave, qytetezave, qyteteve, sisteme shkollore dhe rajone.
- Në nivel të popullatës – të përhapet që të mund të inkorporojë të gjithë popullatën urbane, nëpërmjet përdorimit të internet mjeteve dhe mediave sociale.

Gjithashtu mund të përdoren mjete paralele të cilat posaçërisht do t'i përdorin fëmijët dhe grupet e margjinalizuara. Mjete të posaçme në kudër të kësaj qasje mund të jenë:

- Publikime
- Module dhe prezantime
- Aktivitetet participuese si për shembull: shëtitje në bashkësi, hartim të rreziqeve dhe resurseve, kalendar sezonal, diskutime në fokus grupe, trajnime, simulime.
- Audio dhe video materiale kyçur edhe video, audio klipe dhe këngë apo lloj tjetër të muzikës.

- Ueb faqe
- Media sociale dhe studime telefonike.

## Vlerësim të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve

Më shumë se 60 shoqata nacionale kanë përvoja të caktuara me qasje siç janë vlerësimi i mjerueshmërisë dhe kapaciteteve, me çka përdoren mjete tradicionale të inkorporuara në modulet për trajnim të facilitatorëve si dhe pajisje plotësuese të mjeteve të cilat zbatohen në bashkësi rurale. Ato mund të jenë:

- Shëtitje në bashkësi
- Hartim të rreziqeve dhe kapaciteteve në bashkësi
- Kalendar sezonal
- Diskutime në fokus grupe

Në vitet e fundit shumë shoqata nacionale si për shembull në Paraguaj, Indonezi, Shrilankë dhe Kinë e përdorin vlerësimin për mjerueshmëri të kapaciteteve në mënyrë efektive për integrim të aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katatsrofat. Megjithatë, të punësuarit dhe vullnetarët inkorporojnë mjete bplotësuese dhe në mënyrë aktive studiojnë mënyra për adaptim dhe përgatitje të mjeteve të reja për përdorim në mjedise urbane (si për shembull në Kosta Rikë, Guatemala, Honduras dhe SHBA) dhe mjete të cilat integrojnë edhe çështje lidhur me ndryshimet klimatike.

Tek vlerësimi i mjerueshmërisë së kapaciteteve fokusi i mësimit është i drejtuar në identifikimin dhe prioritetizimin e kërcënimeve dhe rreziqeve, njohje dhe mobilizim të resurseve dhe kapaciteteve dhe fillim të planifikimit të aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Ky proces mund të rezultojë në bashkësi në mënyrën që vijon:

- Zbatim më vete të detyrës dhe përmirësim të sigurisë së bashkësisë (ndryshim).
- Kërkim i përkrahjes nga komuna apo organizata tjera (përfaqësim apo ndikim mbi realizimin e ndryshimit).
- Njohje se vendimi është shum i kopleksuar dhe nevojitet proces afatgjatë (transformim). Kjo mund të çojë edhe kah përfaqësimi për bartjen e ndryshimeve ligjore.

## Planifikim participativ për menaxhim me katastrofa

Planifikimi participativ për menaxhim me katastrofa e udhëheq vlerësimin e mjerueshmërisë së kapaciteteve një hap më para nëpërmjet zbatimit të modelit për procesin afatgjatë vijues të planifikimit për uljen e rreziqeve dhe ndërmarrje të përgjigjes adekuate.

## Udhëzim se si të realizohet hap pas hapi: planifikim të menaxhimit participativ në katastrofa

### Hapi 1: Përgatitje e udhëzimit dhe materiale për trajnim

Udhëzimet dhe materialet për trajnim nevojiten për këto arsye:

- Për evaluim dhe zbatim të masave mbrojtëse adekuate fizike dhe/apo ekologjike
- Për uljen e rreziqeve
- Për përparimin e aftësive për përgjigje gjatë katastrofave

### Hapi 2: Mësim dhe ushtrim të aftësive

Mësimi participativ ndodh gjatë mësimit dhe trajnimit të aftësive, për shembull në fushat në vijim:

- Planifikim të rrugicave për evakuim
- Ndërtim dhe mirëmbajtje të strehimoreve nga ciklonet dhe për renditjen e rezervave të ushqimit
- Ndërtim të kanaleve derdhëse
- Përforcim të mobiljeve dhe pajisje për mbrojtje nga tërmetet
- Trajnime simulative për ushtrim gatishmërie

### Hapi 3: Sigurimi i trajnimit

Nevoja për ndërtimin e aftësive për veprim gjatë katastrofave, mund të plotësohet nëpërmjet sigurimit të trajnimit në fushën e:

- Ndihma e parë
- Triazhë gjatë lëndimeve masive
- Organizim të përgjigjeve
- Kërkim dhe shpëtim
- Fikje të zjarreve
- Komunikim gjatë situatave emergjente

- Përkrahje psiko - sociale
- Bashkim të familjeve

## Hapi 4: Zbatim i trajnimeve dhe simulimeve

Në rast më të mirë trajnimet dhe simulimet sigurojnë më shumë se sa vet mundësia e profesionistëve t'i ushtrojnë aftësitë e tyre dhe t'i përcjellin planet e veta. Ata gjithashtu ofrojnë mundësi për opinionin të bëjë testim real që mundëson të mësohen mësime para se të ndodhë rrezik i caktuar.

Pjesa më e rëndësishme e trajnimeve është pjesëmarrja e plotësishme e bashkësive dhe planifikimi gjithëpërfshirës aksional që ndodh para, gjatë dhe pas trajnimit, që rezulton ndonjëherë me modifikimin e planeve. Trajnimet e mëdha vjetore gjithashtu kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes së opinionit dhe mundësojnë mënyrë që të mësohet nëpërmjet punës. Shembull për këtë janë trajnimet dhe simulimet në Amerikën Latine (Guia practica para la realizacion de simulaciones y simulacros), dhe në HBA (trajnim në Kaliforniwww.shakeout.org).

Përparësitë dhe sfidat e kësaj qasje më poshtë janë prezantuar në Tabela 5.

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Kjo qasje fillon në bashkësitë me identifikimin e tyre të kërcënimeve dhe situatave të mjerueshme që rezulton me ngritje të fuqishme të vetëdijes për rreziqe të mundshme.<br>• Identifikimi i reszrseve dhe kapaciteteve çon kah besimi më i madh dhe vet - mbijetesa<br>• Ndërtohet pjesëmarrje lokale dhe personale në proces.<br>• Siguron mundësi që të integrohen ulja e rreziqeve, programi shëndetësor, uji dhe sanitacioni, mbrojtja e pasurisë dhe adaptimi në ndryshimet klimatike<br>• Nevojitet që bashkësitë pjesëmarrëse të posedojnë të dhëna dhe plane personale<br>• Iu mundëson shoqatave | • Identifikimi i rreziqeve pa zbatimin e aktiviteteve tjera nuk rezulton automatikisht me njohje të vedimeve.<br>• Obligon shumë punë që të realizohet ndikim tek popullata e vogël.<br>• Facilitatorëve iu nevojitet trajnim i madh për përdorimin e metodave participuese studiuese, për punë me njerëz të cilët bëjnë pjesë në kultura të ndryshme, tim billding, dinamikë grupore, regjistrim dhe interpretim të të dhënave<br>• Proceset gjithëpërfshirëse për vlerësimin e mjerueshmërisë dhe kapaciteteve obligojnë vullnetarët dhe pjesëmarrësit e bashkësisë të ndajnë mjaft kohë.<br>• Vendimet mund të jenë komplekse |

| | |
|---|---|
| nacionale dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq të punojnë me njerëzit në vend se për njerëzit.<br>• Tërhiqen vullnetarë, mbindërtohen kapacitetet organizative dhe përmirësohen marëdhëniet mes partnerëve.<br>• Mund tëbazohet në lloje të ndryshme të mjeteve për vlerësimin e bashkësisë që mund të përshtaten në proces.<br>• Ka mundësi nxënës dhe të rinj të marrin pjesë në procese të ngjajshme. | • Nevojiten adaptime për zbatim në mjedise urbane<br>• Nevojat dhe prioritetet e bashkësisë mund t'i tejkalojnë prioritetet e donatorit dhe mundësia e vepruesve të sigurojnë përkrahje.<br>• Aktivitetet për lehtësimin e situatave obligojnë ekzistimin e spektrit të gjërë të materialeve dhe programeve me kualitet të lartë për trajnim.<br>• Aktivitetet për përfaqësim mund të hasin në rrezistim e të ketë nevojë për aftësi dhe përkrahje plotësuese. |

## Qasja 3: Edukim joformal

Fokusi i edukimit joformal është që të përdoren shkurtimisht momentet për stimulimin e të menduarit dhe angazhimin e njerëzve në zbuilimin e aksioneve dhe sjellje për rritjen e sigurisë dhe rrezistimit. Edukimi joformal në bashkësi dhe shkolla është qasje më fleksibile në krahasim me kornizën kohore, publiku qëllimor dhe rrethimi. Në Tabela 6 janë paraqitur lloje të ndryshme të edukimit të kapshëm joformal.

### Tabela 6: Lloje të edukimit joformal

| **Edukimi publik** | **Edukimi në grupe** | **Edukimi i pavarur** |
|---|---|---|
| Në shtëpi | Në shkollë | Në punë |
| **Televizion** | **Radio** | **Internet** |
| Disa minuta | Disa orë | Një apo dy ditë |
| **Posaçërisht i planifikuar** | **Pjesë e projekteve në vijim** | **Në mënyrë spontane** |

Mjetet specifike të cilat mund të përdoren për edukim joformal janë:

- **Publikime** – posterë, udhëzime, fletushka, broshura, fleta pune, vizatime komike, libra për ngjyrosje, lojëra me bashkimin e figurave (puzzle) dhe resurse tjera për ligjërim.
- **Program mësimor, module dhe prezantime -** brifing i mësimdhënësve dhe trajnim në bashkësi.

- **E-mësim** – mësim i pavarur i kompjutorit
- **Shfaqe kulturore dhe artistike -** shfaqe, vallzim, poezi, këngë, teatër, shfaqe me kukulla.
- **Lojëra dhe gara -** lojëra me karta, lojëra me tabëll, role, gara në vizatim, gara në poezi, turnire, radio kuize.
- **Audio dhe video materiale –** video të shkurta, radio programe, programe televizive.
- **Ueb faqe dhe aktivitete -** ueb faqe, lojëra online, kuize online.
- **Media sociale dhe telekomunikacione -** SMS, paralajmërim i hershëm.

Edukimi joformal nënkupton diseminimin e porosive standarde, por me fleksibilitet që të merren parasysh nevojat dhe kujdesjet e publikuttë caktuar specifik lokal. Kjo posaçërisht është efektive për shkak se informacionet për rrethim gjegjësisht përkrahja sociale është thelbësore për ndryshimin e sjelljes së njeriut. Vullnetarët janë liderë dhe shembull i cili duhet ta përcjellë opinioni i gjërë. Mjetet të cilat janë të fokusuara në detektimin dhe zgjedhjen e problemeve mundësojnë vëllim të tërësishëm të aktiviteteve dhe materialeve kreative që do tas tërheqin interesin e publikut të ndryshëm qëllimor.

Shumë mjete për facilitim janë integruar në doaracak për *Kujdesin personal dhe Ndihmë të parë në bashkësi* të përgatitur nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe. Shembull tjetër është kompleti i mjeteve për përgatitjen e fushatave të Kryqit të kuq të Mbretërisë, si dhe doracakut për facilitatorë të Kryqit të kuq të Kanadasë*, në pritje të papriturës.* Në to janë integruar:

- Prezantime
- Diskutime të dedikuara
- Demonstrime, ndihma vizuale
- Interpretim i roleve
- Storje
- Studime të rasteve
- Diskutime në grupe të vogla
- Dramatizim
- Simulim

Aktivitetet me moshatarët janë funksionale edhe tek të rriturit edhe tek rinia e tek fëmijët. Shumë edukime joformale ndodhin në kuadër të një gjenerate të caktuar. Mjetet mundet dhe duhet të tërhjekin vëmendje, të jenë participativ dhe praktik me qëllim që mësimi dhe veprimi të bëhen një dhe të jenë gjë e njëjtë.

Aktivitetet joformale për uljen e rreziqeve nga katastrofat në shkolla janë pjesë e aktiviteteve të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe që nga viti 1970. Ato praktikohen për shkak se janë më të lehta për realizim se sa nëpërmjet edukimit formal dhe për shkak se nuk garojnë me programin e rregullt mësimor. Nga ana tjetër shkollat janë falënderuese për ndihmën, ndërsa nxënësve gjithmonë iu është mirëseardhur ahengu. Shkollat gjithashtu ofrojnë mundësi për funksionimin e grupit rinor të Kryqit të kuq të cilët gjithmonë janë mundësi për angazhimin e anëtarëve të rinj dhe vullnetarëve në organizatë.

Kjo posaçërisht është e realizueshme nëse në shkolla caktohen arsimtarë të cilët do të jenë përgjegjës për punën e këtyre grupeve rinore. Edukimi jo formal në shkolla mund të jetë në shumë forma, mes cilave:

- Diseminimi i publikimeve
- Mbajtja e prezantimeve
- Interpretimi i roleve
- Projekte në bashkësi
- Punë në seksione në shkolla pas mbarimit të orëve të rregullta

Një prej përparësive të edukimit joformal në shkolla është ajo që shkollat mund të funksionojnë si pikë fokale për tërheqjen e bashkësisë së gjërë, nëpërmjet programeve speciale, nëpërmjet prezantimit të punës së nxënësve dhe nëpërmjet dërgimit të porosive në shtëpitë e nxënësve.

Si tek strategjitë tjera, dobia potenciale e edukimit joformal realizohet nëpërmjet rritjes së vëllimit të aktiviteteve, ndarjes së porosive me theks në ndikimin mbi ndryshimet në sjelljen e njerëzve.

Përparësitë dhe sfidat e kësaj qasjeje më poshtë janë paraqitur në Tabela 7

## Tabela 7: Përparësi dhe sfida në qasjen e fushatës

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Argëtim për vullnetarët<br>• Argëtim për pjesëmarrësit<br>• Mund të jetë përkrahje dhe përforcim i fushatave të caktuara më të gjëra<br>• Plotësisht i përdor përparësitë dhe aftësitë e anëve të fuqishme të vullnetarëve | • Qasje e ndryshme në pajtueshmëri me lokalitetin gjeografik kornizë kohore<br>• Planifikimi i vëllimit dhe qëndrueshmëria janë sfidë.<br>• Nuk guxon të ndërhyet në sistemin shkollor për gatishmëri gjatë katastrofave, apo në plan programin mësimor, pa lejen e |

| | |
|---|---|
| • I kyç fëmijët e vegjël<br>• Shkollat janë pikë fokale për | Ministrisë së arsimit.<br>• Aty ku organizata tjera sigurojnë programe të ndryshme për përkrahje, nevojitet që të koordinohen orvatjet me agjencitë tjera.<br>• Duhet të bëhen tentime të posaçme që të përfshihen fëmijët dhe rinia të cilët nuk shkojnë në shkollë. |

## Qasja 4: Intervenime formale në shkolla

Vëmendja e intervenimeve formale në shkolla është drejtuar në 2 fusha: menaxhimi me katastrofa në shkolla dhe plani mësimornë shkolla për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Ato llogariten si pjesë e procesit formal arsimor për shkak se llogaridhënia dhe përgjegjësia për sigurinë në shkolla si dhe programi mësimorështë obligim i ministrisë së arsimit, prandaj atyre u nevojitet përkrahje për planifikim dhe mbindërtim afatgjatë të kapaciteteve. Pa dallim se a ka një institucion përgjegjës apo më shumë, apo ndoshta asnjë, duhet të jetë i kujdesshëm.

Vetën nëse orvatjet nuk janë të pilotuara apo testuara në mënyrë zyrtare dhe sistematike, mangësitë në orvatjet mund ta gropojnë punën në vend se të shkohet kah realizimi i qëllimit kryesor.

Pa dallim të mënyrës së organizimit në shkolla, gjithmonë kur ka mundësi qasja duhet të ketë për qëllim të involvojë grupin e organizatave joqeveritare të interesuara dhe organizatave mes – qeveritare të cilat do të qasen në pushtetet arsimore në shpirtin e bashkëpunimit, me qëllim që të ofrojnë përkrahje dhe të identifikojnë pikën fokale në kuadër të sistemit. Nëse shkollat përgjigjen individualisht , me projekte dhe programe të shumta të pakoordinuara, do të jetë ngarkesë e madhe për ministrinë e arsimit që në fund do të rezultojë si iniciativë joproduktive. Qëllimi është që të mos mbahet sistem paralel, por të përkrahet dhe ndihmohet zhvillimi i kapaciteteve në kuadër të sistemeve ekzistuese publike arsimore. Ekipi gjithashtu duhet t'i qaset dhe t'i kyqë agjencionet të cilat janë përgjegjëse për menaxhim me kriza në shtet.

### Menaxhimi me kriza në shkolla

Qëllimi primar i menaxhimit me katastrofa në shkolla është që të sigurohet sigurimi i nxënësve dhe të punësuarve dhe të mundësohet edukim pa pengesa. Menaxhimi me katastrofa në shkolla obligon proces prticipues vijues të identifikimit të rreziqeve, masa për lehtësimin dhe uljen e rreziqeve dhe

ndërtimin e kapaciteteve për përgjigje. Me qëllim që sistemi të jetë efektiv, atë duhet ta udhëheqintë punësuar në shkollë dhe duhet të sigurojnë rregullore dhe politika për të funksionuar.

Plani shkollor për menaxhim me katastrofa përgatitur në nivel të shkolllës, duhet të jetë dokument i gjallë i cili përmbanprocedura operative standarde për përgjigje në rreziqe të ndryshme, si dhe sigurim të trajnimeve për mbindërtimin e aftësive për përgjigje në katastrofa. Elementet në vijim janë me rëndësi thelbësore:

- Ekzistim i sistemit komandues për organizimin e përgjigjes
- Sistem kundër zjarrit
- Përkrahje psiko - sociale
- Sanitacion
- Evakuim
- Ndihma e parë
- Triazhë gjatë numrit masiv të të pësuarve
- Njohuri të mjaftueshme për kërkim dhe shpëtim
- Komunikime
- Strehimore
- Të ushqyerit
- Procedura për bashkimin e lidhjeve mes nxënësve dhe familjet e tyre

Hartimi global i tanishëm i iniciativave në Kryqin e kuq dhe Gjysmëhënën e kuqe tregon pilotim të suksesshëm të disa elementeve të menaxhimit me katastrofa në shkolla, si për shembull:

- Fushata për siguri në shkolla
- Materiale për trajnim për gatishmëri gjatë katastrofave në shkolla për arsimtarë dhe nxënës
- Shkollat si qendra për evakuim emeregjent
- Ndihma e parë në shkolla
- Mirëmbajtje e shkollave nga ana e bashkësisë

Fillojnë të paraqiten materiale me udhëzime për shkollat dhe ato më tej do të luajnë rol shumë të rëndësishëm.

## Trajnime shkollore

Trajnimet shkollore formojnë pjesë esenciale të procesit për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave në shkolla dhe sigurojnë përvojë të suksesshme prej së cilës mund të mësohet. Ato gjithashtu mund të përcillen dhe notohen nga ana e anëtarëve të bashkësisë shkollore. Mësimet e mësuara inkorporohen në planet për menaxhim me katastrofa në shkolla, dhe vërtetohen qëllime për përmirësimin e punës në këtë sferë në periudhën që vijon. Varësisht nga rreziqet potenciale, eklzistojnë disa lloje të trajnimeve të cilat mund të ushtrohen:

- Trajnim për evakuim (nëse objekti nuk është i sigurt)
- Evakuim nga vendi i ngjarjes (nëse vendi nuk është i sgurt)
- Formimi i strehimores (procedura për strehim nëse siguria jashtë objekt nuk është e sigurt)
- Mbyllje të shkollave (mbajtja e nxënësve brenda objektit në rast të sulmit)

Shumë aftësi dhe protokole individuale, mund të ushtrohen individualisht, apo si pjesë e trajnimeve simulative gjithëpërfshirëse:

- Procedura për lirimin e nxënësve (bashkim i sigurt i familjeve)
- Procedura gjatë tërmetit
- Mbajtje të jelekëve mbrojtëse për shpëtim në ujë dhe aktivitete ushtruese (gjatë vërshimeve dhe cunamit)
- Trajnime kundër zjarrit
- Aktivitete të duhura për kërkim dhe shpëtim
- Triazhë jomjekësore gjatë numrit masiv të të pësuarve
- Komunikim gjatë situatave emergjente
- Organizim fleksibil dhe caktim i përgjegjësive
- Marrëdhënie me publikun, komunikime dhe dokumentim
- Procedura gjatë zjarrit
- Siguri gjatë vetëtimës
- Ndihma e parë
- Sistem komandues gjatë fatkeqësive
- Qasje në dispozita për veprim gjatë katastrofave
- Transport dhe procedura për lokacione jashtë shkollës
- Evakuim kah shkolla

Shkollat gjithashtu duhet t'i trajnojnë rregullat për evakuimin e objektit si këto të paraqitura më poshtë me qëllim që të sigurohet përgjigje e drejtë e të punësuarve dhe fëmijëve në rast të situatës emergjente.

**Rregullat e të vepruarit gjatë trajnimit për evakuimin e objektit të shkollës:**

- Mos u shty.
- Mos vrapo.
- Mos fol.
- Mos u kthe prapa.
- Mësimdhënësit duhet të ndahen me atë që njëri do të jetë para e njëri prapa pas 2 klasave.
- Gjatë daljes largohuni mënjanë nga objekti për shkak sigurie.
- Mblidhuni qetë dhe shihni se a janë këtu të gjithë nxënësit.

## Programi mësimor

Programi mësimor për realizimin e aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat zhvillohet në 3 forma kryesore, dhe secila prej tyre korespondon në kontekste të ndryshme:

- Kurse të pavarura
- Module të shkurta integruese (tema specifike edhe për vite/gjenerata specifike)
- Tekste, ushtrime, zgjedhje të problemeve dhe aktiviteteve të integruara në programin mësimor.

Mjetet në këtë fushë bien në kategorinë e programit mësimor, module dhe prezantime si për shembull:

- Libra shkollor
- Studime të rastit
- Materiale për mësim
- Module
- Trajnime
- Mjete joformale për edukim

Kurset e pavarura janë shumë më të lehta për sigurimin e përkrahjes nga veprues të jashtëm por janë shumë më të vështira për kyçje në programin e caktuar mësimor. Për të gjitha format nevojitet përafërsisht renditje e njëjtë e hapave dhe udhëheqje nga ana e ekspertit profesional, siç është përshkruar më poshtë.

## Udhëzim hap pas hapi: përgatitje e kursit të pavarur

**Hapi 1:** Identifikimi i programit mësimor për edukim publik si dhe ekspertë për përmbajtjen e duhur me të cilat do të punohet në partneritet.

**Hapi 2:** Njoftimi juaj me planin ekzistues mësimor të shkollës që të shihni se a janë përfshirë çështjet për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe adaptimi e lehtësimi i pasojave nga ndryshimet klimatike, dhe ku mund të jenë të avancuara apo të futura.

**Hapi 3:** Marrëveshje në bazë të vëllimit dhe renditjes së rezultateve.

**Hapi 4:** Përgatitje e përmbajtjes për nxënës.

**Hapi 5:** Përgatitje e materialeve dhe/apo trajnim për nxënës.

Sistemet e mira edukative kalojnë nëpër cikle për miratimin e programit mësimor që zakonisht zgjasin prej 5 deri në 10 vjet. Edukuesit profesional e përcjellin vëllimin dhe renditjen e diturive, kompetencat dhe aftësitë për secilën pjesë lëndore, përputhje të librave për mësim, zgjidhje dhe aktivitete për zbulimin e përmbajtjeve të caktuara. Për këtë qëllim nevojitet të identifikohen materiale të shtypura dhe digjitale mësimore apo nëse nuk ekzistojnë ato duhet të përgatiten. Kjo do të thotë se integrimi i moduleve të reja në lëndë dhe vit shkollor të caktuar, apo integrimi i modulit në programin mësimor në shumë vite dhe lëndë shkollore, zakonisht është proces afatgjatë.

Shumë edukatorë besojnë se programi mësimor duhet të dizajnohet në mënyrë e cila do t'i mundësojë të jetë gjallë, dhe mjaft fleksibil ta inkorporojë përmbajtjen lokale në pajtueshmëri me realitetet lokale. për shembull, edhe pse lëndët shkencore dhe gjeografia shpesh herë përmbajnë informacione për katastrofa natyrore, këto informacione, mund të struktuohen me qëllim që mësimdhënësit t'i lidhin me kontekstin lokal, si për shembull:

- Identifikoni gjërat të cilat iu paraprijnë rrëshqitjeve të tokës
- Inkorporimi i sistemit monitorues për përcjelljen e sasisë lokale të të rreshurave në sistemet për paralajmërim të hershëm
- Metoda për stabilizimin e shpateve dhe ndalim të rrëshqitjes së dheut.
- Planifikimi i shfrytëzimit të tokës
- Rrugica dhe procedura të sigurta për evakuim

Me fjalë tjera nuk mjafton të ekzistojë vetëdije e thjeshtë apo gjëra abstrakte të shkencës apo gjeografi në arsim.

Fillimisht, të punësuarit apo vullnetarët duhet të punojnë në përmirësimin e kapaciteteve të mësimdhënësve. Megjithatë, në plan afatgjatë kjo duhet të bëhet nëpërmjet trajnimit formal të vazhdueshëm për mësimdhënësit në institucione të specializuara. Mësimi elektronik në formë të kurseve digjitale të pavarura për arsimtarë dhe nxënës gjithashtu mund të jetë mënyrë e mirël për sigurimin e diturive të nevojshme dhe atë mund të organizohet me ndihmën e DVD kurseve apo nëpërmjet internetit, aty ku lejojnë kushtet. Përparësitë dhe sfidat e kësaj qasjeje më poshtë janë prezantuar në Tabela 8.

## Tabela 8: Përparësi dhe sfida të qasjes që zbatohet nëpërmjet programit mësimor

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Integrimi në uljen e rreziqeve nga katastrofat në planin mësimor siguron proces të vazhdueshëm të mësimit në periudhë të gjatë.<br>• Është shumë ëehtë të identifikohen dhe futen segmente të caktuara në planin ekzistues mësimor në të gjitha klasat dhe vitet, dhe në shumë lëndë të ndryshme kyçur në shkencat natyrore, ekologji, gjeografi, histori, shkenca sociale, gjuhë dhe letërsi, shëndet dhe siguri dhe e drejta qytetare.<br>• Materialet me modulet e nevojshme mundet relativisht të përgatiten shpejtë.<br>• Pa u inkorporuar në programin mësimor, shembujt për uljen e rreziqeve nga katastrofat, mund të përdoren për përkrahjen e qëllimeve në arsimimin, të shkruarit, mësimin e numërimit, të menduarit thelbësor, zgjidhjen e problemeve dhe mësimin koorperativ<br>• Integrimi në programin mësimor obligon nevojë më të vogël të mbindërtimit të kapaciteteve për shkak se përmbajtja përshkruhet shkurtimisht në shumë lëndë. | • Institucionet përgjegjëse dhe mësimdhënësit nga sfera e arsimit ndoshta do të mendojnë se nuk munden të shtojnë një apo më shumë gjëra në programin mësimor.<br>• Kurset e pavarura mund të ofrohen vetëm si elemente zgjedhëse, ndërsa modulet mund të përdoren vetëm në bazë vullnetare nga ana e mësimdhënësve të interesuar.<br>• Mësimdhënësit mund të ndjehen jo mjaft të aftë të ligjërojnë material të panjohur dhe mund të kërkojnë përkrahje plotësuese.<br>• Bashkëpunimi me organet arsimore në kontekst të miratimit të cikleve në programe mësimore, obligon angazhim afatgjatë nga ana e kuadrove dhe profesionistëve mësimor. |

# 4. Parime të implementimit efektiv

Kjo kaptinë shqyrton 4 principe kyçe të cilat duhet të zbatohen gjatë ngritjes së vetëdijes publike dhe edukimit publik për uljen e rreziqeve nga katastrofat:

- Vijueshmëri dhe porosi standarde
- Legjitimitet dhe kredibilitet
- Vëllim
- Qëndrueshmëri

Secili prej tyre është përshkruar me rend.

## Principi 1: Vijueshmëri dhe porosi standarde

Për planifikim të suksesshëm para opinionit të gjërë duhet të përgatiten porosi kyçe për përforcimin e sigurisë dhe rrezistencës së popullatës. Këto porosi patjetër duhet të jenë standarde dhe vijuese me qëllim që të kenë kredibilitet, legjitimitet dhe ndikim të fuqishëm. Ato gjithashtu patjetër duhet të jenë me koncezus nga vepruesit kyç dhe të bazohen në dituri të kapshme të qëndrueshme, shkencore dhe lokale.

Porositë standarde llogariten si qëllim primar në edukimin për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe ato posaçërisht janë të rëndësishme kur ka nevojë të rriten orvatjet për krijimin e kulturës së sigurisë. Nëse porositë janë të paqartam rezultati direkt është konfuzion, mosbesim, apati dhe mangësi e aksionit. Kur porosi të njëjta vijnë nga autoritete  dhe veprues të ndryshëm, atëherë është shumë lehtë të sjellet vendim për ndërmarjen e hapave rekomanduese pozitive.

Përmbajtja e porosive standarde duhet të jetë e përpiluar nga porosi për lehtësimin e situatave, përmirësimin e gatishmërisë dhe sjelljen e njerëzve apo në bazë të të gjitha katastrofave apo të jenë të dedikuar për rreziqe të caktuara specifike. Standardet mund të përgatiten në nivel global, rajonal dhe nacional. Për shkak se porositë ndahen me popullatën e gjërë, ato kanë për qëllim të përmbajnë udhëzime specifike në lokacion të caktuar.

Shembull i porosisë standarde e cila me sukses është implementuar në nivel global është aktiviteti ndërkombëtar për shkatërrimin e pandemisë nga virusi H1N1 (tek populli njihet si gripi i derrave) në vitin 2009. Porositë e Federatës ndërkombëtare ishin të gatshme në pajtueshmëri me udhëzimet e siguruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ato u përgatitën me kujdes me sllogan jashtzakonisht të zëshëm “Mbrojtja më e mirë jeni ju”. 5-së udhëzime të thjeshta dedikuar për të gjithë, u drejtuan në sjelljen individuale:

- Lani duart.
- Mbuloeni gojën.
- Rrini në distancë.
- Ndani anëtarët e sëmurë të familjes
- Hudhni mbeturinat.

Udhëzimi i fundit ishte “Për më shumë informacione, thirrni në këtë numër.....”

Në ueb faqen e fushatës kishte elemente interaktive multimediale dhe material për botim i cili ishte i kapshëm për shkarkim. Secila prej këtyre porosive është e vlefshme nëse mbahet mend dhe ushtrohet veçmas. Së bashku, 5-së porositë formojnë qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive për preventivë të sëmundjeve të cilat barten nëpërmjet ajrit. Shumë shoqata nacionale e implementuan këtë program, duke përshtatur në nevojat e veta lokale.

Ngjajshëm me këtë, porosia standarde e zyrës së Kryqit të kuq / Zyra BE në lbazë të gatishmërisë gjatë katastrofave përmbante 10 hapa, të përmbledhura nën një sllogan të vetëm “Të informuar, të gatshëm, së bashku”.

## Standarde rajonale

Shembull për nevojë të standardeve rajonale u paraqit në Azinë jugore. Vullnetarët e Kryqit të kuq ishin të frustruar me që ndihma e parë njihet si mënyrë efektive, e sigurt dhe e thjeshtë për shpëtimin e jetës, dhe secilit i rekomandohet të ketë kuti për ndihmë të parë.

Iniciativa për Ndërtimin e Bashkësive të Sigurta vendosi të ndërmarrë aksion në të gjitha shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në drejtim të përgatitjes së udhëzimit për kutinë standarde për ndihmë të parë. Për këtë qëllim u kërkua ndihmë nga Kombet e Bashkuara gjegjësisht nga Rrjeti për Këmbimin e Vendimeve.
Procesi i konsultimit solli deri në përgatitjen e katër modeleve të kutive, dhe të gjitha u prezantuan në Kriter standard për kuti për ndihmën e parë:

- Kuti për ndihmë të parë familjare
- Kuti për vullnetarë të trajnuar nga ndihma e parë
- Kuti shkollore për ndihmë të parë
- Kuti për ndihmë të parë gjatë kërkimit dhe shpëtimit

Gjithashtu pakoja përmbante edhe udhëzimin për mbrojtje dhe higjienë personale. Në disa prej vendeve gjithashtu u dhanë edhe udhëzime për ballafaqim me disa kërcënime, siç është për shembull kafshimi nga gjarpëri.

Në këtë shembull, standardi rajonal posaçërisht është i dobishëm për popullatën e përgjithshme. Ai siguron model për secilën shoqatë nacionale. Në secilin vend, pushtetet për mbrojtje civile dhe shëndetësore janë pjesëmarrës të vyeshëm në përgatitjen e koncenzusit nacional i cili ndërtohet rreth këtyre standardeve apo rekomandimeve.

Në nivel nacional plani familjar për gatishmëri gjatë katastrofave, shpesh herë është pikë fillestare për porositë standarde. Shembull i mirë për këtë është porosia e Kryqit të kuq të Australisë në katër hapa "Jeni të informuar. Planifikoni. Siguroni pajisje për situata emergjente. Njoftoni fqinjët" (www.redcross.org.au/ourservices_acrossaustralia_emergencyservices_prepare.htm).

Porosia është gjithëpërfshirëse dhe përfshin spektër të aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat lidhur me rreziqe të ndryshme. Hapat janë mjaft të shkurta që të mbahen mend dhe njihen si ftesë për ndërmarrjen e aksionit. Secila prej katër hapave është prezantuar në ngjyrë të ndryshme, përkrahur me informacione detaje lehtë të kapshme.

Vazhdimësia zakonisht obligon partneritete. Shpesh herë donatorët financojnë disa organizata që të punojnë në aktivitete për uljen e katastrofave në vend të caktuar. Këtu bashkëpunimi gjatë përgatitjes së porosive standarde dhe përgatitjes së informacioneve të përbashkëta, materialeve për edukim dhe komunikim me më shumë logo mundëson që të gjitha qasjet të jenë të suksesshme.tani më disa dekada, porositë standarde për gatishmëri gjatë katastrofave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e inspirojnë besimin publik dhe në porositë gjenden logo të 3 institucioneve të njohura: Kryqi i kuq i Amerikës, Shoqata gjeologjike e SHBA dhe Agjencioni federal për menaxhim me situata emergjente.

Viteve të fundit paraqitet forum i njohur si koalicion i organizatave për edukim për katastrofa që bashkon 25 agjencione qeveritare dhe organizata joprofitabile arsimore në fushën e promovimit të porosive edukative gjithëpërfshirëse për ngritjen e vetëdijes për gatishmëri gjatë katastrofave nën emrin *Biseda për katastrofa: Udhëzim për porosi standarde.*

Ky dokument siguron porosi vijuese, të sakta dhe në kohë. Persona profesional i ndihmojnë grupit që të sigurojë koncenzus në porositë të cilat organizatat e përcjellin në bazë vullnetare. Kryqi i kuq i Amerikës siguron personel për organizimin e punës së këtij koalicioni vullnetar.

Në kontekst të kornizës për bashkësi të sigurt dhe rrezistuese, mund të bëhet shumë më shumë për përforcimin e porosive standarde – në nivel global, rajonal dhe nacional – në periudhën që vijon.

## Parimi 2: Legjitimitet dhe kredibilitet

Në përgjithësi legjitimiteti është kualiteti i përcjelljes së një parimi të caktuar. Kredibiliteti është kualiteti i besimit apo të besuarit në diçka. Disa njerëz mendojnë se legjitimiteti dhe kredibiliteti i Lëvizjes dalin në mënyrë primare nga raporti me qeveritë dhe roli efektiv në veprimin gjatë katastrofave. Megjithatë, vullnetarët të cilët janë esenca e shoqatave nacionale, besojnë se legjitimiteti vjen nga demonstrimi praktik i parimeve elementare, ndërsa kredibiliteti del nga puna e ndërmarrë për të përforcuar bashkësitë dhe ulje të vuajtjes së njeriut.

Për shkak se Lëvizja din se ndikimi i katastrofave, varfëria, pabarazia, pasiguria dhe ndryshimet klimatike janë largë të mëdha se sa kapaciteti i Lëvizjes të përgjigjet në të gjitha situatat, por për shkak se ka qasje në dituritë e nevojshme për realizimin e sigurisë dhe rezistencës, Lëvizja është e obliguar me parimet e veta ta ndajë dhe zhvillojë edhe më tej këtë dituri. Prandaj, nevojitet ndërmarrje e edukimit të opinionit në bazë të legjitimitetit dhe kredibilitetit të Lëvizjes.

Aspekt kyç i legjitimitetit dhe kredibilitetit është “Të jetë ndryshimi të cilin dëshironi ta shihni”. Shoqatat nacionale të punësuarit dhe vullnetarët duhet të veprojnë si shembull pozitiv në të gjitha sferat. Për individët, kjo mund të thotë:

- Dhënie gjaku
- Praktikim i higjienës së mirë dhe larje e duarve
- Respektimi i rregullave për siguri në komunikacion dhe bartje të rrypave të sigurimit
- Përcjellje e porosive për promovim shëndetësor
- Ndalim i pirjes së duhanit në vendet e punës

Në mënyrë organizative kjo mund të thotë:

- Zyrat e shoqatës nacionale të jenë të vendosura dhe të ndërtuara në mënyrë e cila tregon se janë rrezistuese në katastrofa.
- Rrugicat e daljes gjithmonë të jenë të kalueshme në rast të evakuimit.
- Dyert të hapen nga jashtë.
- Në zona seizmike të rrezikshme mobiljet të përforcohen për mure dhe qendrat e shëndetësisë gjithmonë të jenë të pajisura mirë dhe funksionale.
- Zbatimi i trajnimeve të rregullta

Nëse njerëzit në qendër dhe organizatat komunale, nuk besojnë dhe nuk veprojnë në bazë të promovimit të masave për lehtësimin e situatave, gjasat për sukses në domenin e edukimit publik janë minimale. Njësoj siç thuhet në

udhëzime të cilat i dëgjojmë në aeroplan “Nëse shtypja në kabinë bie ... së pari vendoseni maskën në fytyrë”, vullnetarët dhe të punësuarit patjetër të kuptojnë se nëse ata dëshirojnë të jenë efektiv dhe të suksesshëm në sigurimin e mbrojtjes së popullatës së mjeruar, atëherë fillimisht duhet të kujdesen për vete.

Studimet tregojnë se edhe nëse njerëzit i kuptojnë rreziqet, prapë ata besojnë se më e keqja do t’i ndohë dikuj tjetër. Ky besim gjithashtu është i pranishëm edhe tek organizatat ndërkombëtare, asociacionet qytetare dhe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Ka më shumë shembuj të programeve të cilat kanë kontribuar në përforcimin e legjitimitetit:

- Qendra e Kryqit të kuq të Japonisë ka rezervat e veta të ushqimit dhe ujit për 400 të punësuar për periudhë prej 3 ditëve në lokacionin e vet. Ato ruhen si rezervë në rast të aktivitetit seizmik.
- Kryqi i kuq i Kolumbisë bën orvatje enorme në zyret e veta të mos përdorë letër me qëllim që të ulet ndotja e mjedisit jetësor.
- Disa shoqata nacionale kanë ndërmarrë aktivitete për ngritjen e vetëdijes gjatë katastrofave, posaçërisht gjatë tërmeteve nëpërmjet ndarjes virale të porosive me përmbajtje shkencore për pasojat e dëmshme të cilat mund t’i nxisin tërmetet.

Për shkkak se shoqatat nacionale ndërmarrin mori përqindjesh të rreziqeve dhe aktivitete për lehtësimin e situatave, së shpejti presim të shohim edhe shumë shembuj të tilla.

Gjithashtu kredibiliteti prehet në kualitetin dhe koncenzusin rreth porosive për edukimin e opinionit.

## Parimi 3: Vëllimi

Vëllimi ka të bëjë me mundësitë që të bëjmë më shumë (njëra prej anagzhimeve kyçe të strategjisë 2020), nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve për numër më të madh të njerëzve. Pa dallim të strategjive, qasjeve dhe mjeteve të cilat do t’i zgjedhim, njëra prej sfidave më kryesore është se a munden ato të zbatohen në mënyrë globale që të mund të ulen vuajtjet nga katastrofat.

Ekzistojnë 2 sfida ekstreme lidhur me vëllimin, por edhe për të dyja nevojiten vuajtje të mëdha. Nga njëra anë më shumë se gjysma e popullatës në botë tani jetojnë në qytete. Shumica e metropoleve botërore (me popullatë më shumë se

10.000.000) ballafaqohen me rreziqe seizmike. Qindra qytete ballafaqohen me vërshime dhe stuhi.

Ekziston nevojë emergjente t'i ndihmohet kësaj popullate të madhe urbane në plan ekonomik dhe politik. Nga ana tjetër, shtrirja e gjërë gjeografike e popullatës rurale në lokalitete të largëta dhe të pakalueshme, paraqet pajisje të ndryshme të sfidave të cilat janë në rritje.

Kohë pas kohe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë viktima të suksesit të vet personal. Në Siri, shoqata nacionale filloi fushatën për siguri në rrugë në 20 shkolla dhe përgatiti lojë me gjarpërinj dhe shkallë në bashkëpunim me UNICEF.

Ky pilot projekt ishte aq i suksesshëm sa që shteti kërkoi të përhapet në 13.000 – 14.000 shkolla. Njëri prej të punësuarve atëherë tha: “Duhet të pyeteni. Çka do të bënit nëse do të kishit sukses?”.

Zakonisht pengesa më e madhe janë paratë. Dizajnimi i mirë i programit zakonisht duhet të përpunojë strategji të cilat do të jenë të mundshme që të financohen për shkak se nevojat vazhdimisht rriten dhe ato gjithmonë janë më të mëdha se ajo që është planifikuar fillimisht.

Në tabelën 9 janë paraqitur pjesë e mënyrave për rritjen e ndikimit.

## Tabela 9: Metoda për rritjen e vëllimit të ndikimit

| Metoda | Këshilla se si të bëhet |
|---|---|
| Diseminim i lirshëm i të gjitha mjeteve | Bëni që lehtë të zbulohen online dhe të jenë të kapshme në më shumë formate të më shumë gjuhëve. |
| Ndarja e shpenzimeve | Kërkoni sponsorë nga sektori privat dhe përfaqësuesit e vetqeverisjes lokale t'ju ndihmojnë t'i botoni dhe shpërndani materialet. |
| Përdorimi i modelit kaskadë të trajnimit | Si e para, bëni trajnime që të mund të aftësoni aftësues, që ata më vonë të mund të aftësojnë më shumë njerëz etj. secili grup në zinxhirë duhet të jetë në gjendje të realizojë qëllime të caktuara. Përcjelleni kualitetin. |
| Radio dhe televizion | Programet argëtuese, serviset publike dhe lajmet arrijnë tek miliona njerëz – por ato zgjasin vetëm disa minuta. Merruni vesh me serviset publike të ndajnë kohë me qëllim t'ju mundësojnë dërgimin e porosive. Përsëritja është me rëndësi thelbësore. |
| E-mësim | Kur është dizajnuar mirë, tregohet si efektive njësoj edhe si mësimi në klasë. Njerëzit kanë qasje në materiale 24 orë, 7 ditë në javë, dhe nuk turpërohen nëse bëjnë gabime. Më e dobishme është kur keni mungesë të trajnuesve të aftësuar açp kur keni mjete të kufizuara për atë qëllim. Me këtë ulet nevoja për udhëtim, ulen shpenzimet dhe në mënyrë maksimale shfrytëzohet koha. |
| Bilborde dhe banerë | Kjo qasje bart porosi kyçe tek publiku i madh. Kualiteti patjetër të jetë i shkëlqyeshëm që të realizohet ndikimi i dëshiruar, prandaj mësoni prej të tjerëve dhe shifni se çka është funkcionale. Mundohuni edhe me reklamimin e mjeteve për transport publik. |
| Gara sportive, koncerte humanitare dhe telefona | Në ngjarjet ku janë të pranishëm shumë njerëz keni mundësi ta popullarizoni çështjen tuaj që të merret përshtypje se secili e bën atë. Lidhuni me shampionat të cilët duan të japin përkrahje për kauzën tuaj. |
| Bashkëpunim i përbashkët | Bashkëpunoni me programe tjera, dha shpërndani shpenzimet. Futni porositë tuaja edhe në llogaritë për shërbime komunale. Shpërndani edhe informacione edhe në vendet për pritje në spitale. Kërkoni hapësirë për reklamim në ueb faqe që japin mundësi të mira. |
| Përdorimi i përgjigjes dhe rimëkëmbja | Promovimi i arsimimit për uljen e rreziqeve në çdo mundësi – posaçërisht kur nevojat janë të mëdha e njerëzve iu nevojiten përgjigje. |

## Parimi 4: Qëndrueshmëri

Qëndrueshmëria ka të bëjë me ngritjen e vazhdueshme të vetëdijes dhe orvatje për edukimin e opinionit në periudhë më të gjatë kohore me qëllim që të jepet kontribut në ngitjen e kulturës së sigurisë.

Në qëndrueshmëri ndikojnë çështjet në vijim:

- Rritja e shpejtë e popullatës, urbanizimit dhe migracionit;
- Teknologji të reja që rezultojnë me rreziqe më të mëdha (si për shembull, materiale të caktuara ndërtimore dhe praksa ndërtimore);
- Mungesë e vetëdijes për teknologji të kapshme për uljen e rreziqeve;
- Intervale të gjata mes katastrofave të caktuara natyrore (si për shembull, shpërthime vullkanike, tërmete, cunami dhe vërshime që ndodhin në 100 vjet);
- Ndikimi i ndryshimeve klimatike;
- Humbja e memorjes kolektive të diturive lokale, apo pamundësi për adaptim;
- Bartje e diturive e ulur mes gjeneratave;
- Modele afatshkurte donatore për financim projektues;
- Pritje donatore për qasje të reja në vend të përmirësuara dhe të qëndrueshme;
- Mungesë e resurseve financiare për rritjen e vëllimit të aktiviteteve;
- Ngopje e vullnetarëve;
- Mungesë të matet përparimi.

Qëndrueshmëria mund të përparohet nëpërmjet:

- Identifikimit të aktiviteteve të cilat mund të përsëriten në intervale të rregullta pa paraqitur ngarkesë;
- Krijimit të mundësive për inovacion dhe kreativitet;
- Mundësimit të aktiviteteve që të bëhen pjesë e pritjeve të vullnetarëve dhe të rinjve;
- Përdorimit të këtyre aktiviteteve për rritjen e bazës vullnetare;
- Shpërndarjes së diturive me partnerë valid që të institucionalizohen orvatjet;
- Shpërndarjes së diturive me institucionet arsimore që të univerzohen orvatjet;

- Shpërndarjes së diturive me organizata tjera joqeveritare që të ndahen përgjegjësitë;
- Shpërndarjes kah e ardhmja dhe zbatimi i proceseve të cilat do të mundësojnë përshtatje dhe përmirësime me qëllim që të mbahet vazhdimësia e nevojshme;
- Integrimit të elementeve konkurente (për shembull, ndarja e shpërblimeve dhe mirënjohjeve);
- Matjes dhe reklamimit të sukseseve;
- Selektimit të liderëve të aftësuar;
- Shpërndarjes së punës dhe dhënies së mirënjohjes për realizimin e partnerëve.

# 5. Mjete

Kjo kaptinë jep shqyrtim dhe përshkrim detal i mjeteve në vijim:

- Publikime;
- Programe mësimore, module dhe prezantime;
- E-mësim;
- Shfaqe dhe pika artistike;
- Lojëra dhe gara;
- Audio dhe video materiale;
- Ueb resurse;
- Media sociale;
- Telekomunikacione.

Në secilën kategori ka shembuj të aktiviteteve dhe janë paraqitur përparësitë dhe mungesat e secilit mjet për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit. Pastaj shqyrtohet edhe aspekti i kombinimit të mjeteve të ndryshme me qëllim që të arrihet në ndryshimin e dëshiruar.

## Publikime

Tani më një kohë të gjatë, publikimet janë mjeti i dëshiruar për shpërndarjen e porosive për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit publik. Publikimet kanël fleksibilitet të pafund dhe mund të paraqiten në forma të materialeve të botuara apo digjitale, dhe gjenden në forma dhe madhësi të ndryshme. Ato mund të

përdoren për reklamim (si në bilborde dhe postere), komunikim (për shembull, materiale për trajnim apo lojëra), dhe shumë funksione tjera. Mundësitë, qëllimet, publiku potencial dhe vëllimi i tyre i shpërndarjes më poshtë janë paraqitur në Tabela 10.

## Tabela 10: Llojet e publikimeve

| Lloji | Qëllimi i publikut | | | Shpërndarja | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Popullata e përgjithshme | Rinia | Fëmijë | Sasi masive | Aq sa lejojnë mjetet | Botim i kufizuar | Forma elektronike |
| Bukmejkerë – përkujtues për porosi kyçe dhe informacione për kontakt | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | | |
| Të dhëna faktografike, fletushka, broshura – porosi kyçe për fushata | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ |
| Libreza – udhëzime, rezime, udhëzime stzandarde | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ | ✓ | |
| Kartela informative – rikujtues xhepi për procedura dhe metoda të rëndësishme si për shembull udhëzim për evakuim, rrugica për evakuim, triazhë, ndihma e parë, rijetësim dhe ujë e sanitacion. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ |
| Plan familjar për katastrofa dhe porosi tjera kyçe – udhëzim dhe procedura. Doracak dhe udhëzime – materiale gjithëpërfshirëse kyçur edhe materiale për aftësues dhe pjesëmarrës në trajnime. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ |
| Fletore pune dhe flet pune – materiale interaktive për përmirësimin e mësimit. | ✓ | ✓ | | | ✓ | | ✓ |
| Letër flipçart – materiale në letër tabak të cilat i përdorin aftësuesit për dhënien e udhëzimeve gjatë facilitimit. | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ | | ✓ |
| Studime të rastit – materiale të cilat dokumentojnë dhe ndajnë mësime t mësuara dhe resurse. | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ | |
| Kalendarë – përkujtues të dobishëm | ✓ | | | | ✓ | ✓ | ✓ |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| me komplete prej 12 apo më shumë porosi. | | | | | | | |
| Postere – materiale për ekspozimin e informacioneve të cilat nuk janë shumë detale. | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ | | |
| Banerë dhe shenja – material reklamues për ngjarje të rëndësishme | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ | |
| Bilborde – porosi të mëdha fushate të cilat janë përpunuar me kujdes por jo shumë që bien në sy | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ | |
| Revista –komplet të më shumë porosive apo botim special, apo përmbajtje që përfshin më shumë tituj | ✓ | ✓ | | | ✓ | | ✓ |
| Ilustrime – notime të rregullta grafike strip me tregime të shkurta argëtuese | | ✓ | ✓ | | ✓ | | ✓ |
| Fleta për ngjyrosje – udhëzim për gatishmëri, mjet arsimor. | | | ✓ | | ✓ | | ✓ |
| Libra me storje – të vërteta apo fiktive | | ✓ | ✓ | | ✓ | | ✓ |
| Lojëra shoqëruese, lojëra me tabëll, modele – bëni lojën tuaj të shtypur personale. | | ✓ | ✓ | | ✓ | | ✓ |
| Mjete pres – komplete materiale për gazetarë (të botuara, audio apo video) | ✓ | | | | | ✓ | ✓ |
| Resurse për DVD, CD apo memori disqe – kombinime të ndryshme të materialeve | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ | ✓ |
| Material reklamues – ngjitëse, magnetë, tatu të përkohshme, lapsa, goma, fletore etj. | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ | | |
| Materiale më të mëdha reklamuese – maica, kapela, torba, shishe plastike, mbulesa për jastëk, pajisje për ndihmë të parë. | ✓ | ✓ | ✓ | | | ✓ | |

Vendimi për llojin e materialit më adekuat për shpallje do të varet prej:

- Publikut qëllimor;
- Sasia e porosive të cilat duhet të barten;
- Numri i nevojshëm për shpërndarje;
- Metoda të diseminimit;
- Qëndrueshmëri e nevojshme e prodhimit.

Pothuajse të gjitha materialet e publikuara mund të jenë të kapshme në publikun e gjërë si për shembull ueb faqet për online apo si dokumente të cilat mund të shkarkohen, prej DVD, CD-ROM dhe memoridisk. Disa porosi

gjithashtu mund të optimalizohen për shpërndarje nëpërmjet telefonave celular apo pajisje dore.

Ka sasi të mëdha të materialeve të publikuara dhe materialeve edukative dhe publikime të cilat e tërheqin vëmendjen. Prandaj gjatështpërndarjes masive, përmbajtja dhe dizajni i materialeve patjetër duhet të jenë të kapshme dhe ta tërheqin vëmendjen. Paramendoni si dhe kur pritni që njerëzit ta përdorin prodhimin tuaj dhe çka dëshironi të realizoni pasi ata ta lexojnë. Caktoni qëllime të qarta se çka dëshironi të arrini me materialet dhe testoni para se të përgatitni sasi të mëdha. Testimi ndoshta ju duket në anulim të panevojshëm, por kjo është investim i rëndësishëm që vlen në bazë dhe në kohë të rvatjeve.

Është shumë me rëndësi të përcaktohet se a do të botohet publikimi apo do të shpërndahet nëpërmjet postës elektronike. Sa më shumë që janë materialet interaktive, aq do të jenë më efektive dhe do ta tërheqin vëmendjen e lexuesit dhe do të kontribuojnë për ndryshimin e sjelljes. Publikimet mund të dizajnohen për publik qëllimor të caktuar dhe mund të përmbajnë porosi kyçe apo informacione më të hollësishme përderisa janë të dedikuara për aftësues apo për mësim personal. Disa prej materialeve janë të dizajnuara që të përdoren vetëm një herë, përderisa tjerat duhet të ktheheni përsëri dhe përsëri.

Në tabelat 11 dhe 12 më poshtë janë paraqitur përparësi dhe sfida në bazë të asaj se a do të botohen materialet apo do të shpërndahen në mënyrë digjitale.

**Tabela 11: Përparësi dhe sfida në bazë të shpërndarjes së materialeve të botuara.**

| Shpërndarja e materialeve botuese | |
|---|---|
| **Përparësi** | **Sfida** |
| • Secili dëshiron ta prekë dhe ta mabjë në dorë<br>• Materialet e botuara tërhjekin vëmendje<br>• Mund të përdoren më shumë herë<br>• Mund të jenë të dedikuara për publikat e ndryshme<br>• Mund të jenë interaktive dhe të promovojnë ndryshim në promovim. | • Ka pasoja për mjedisin jetësor, zakonisht për drunjtë që përdoren për prodhimin e letrës si dhe transportin.<br>• Ndoshta materialet nuk do të lexohen.<br>• Nëse nuk testohet ndikimi nuk do të dihet se si do të jenë efektet<br>• Mund të jenë me kualitet të dobët, dhe të lënë përshtypje të gabuar |

**Tabela 12: Përparsi dhe sfida në bazë të shpërndarjes digjitale të materialeve**

| Shpërndarja e materialeve digjitale | |
|---|---|
| **Përparësi** | **Sfida** |
| • Ulen shpenzimet për botim dhe transportim.<br>• Mund të dorëzohen nëpërmjet internetit (pa pagesë)<br>• Mund të futen në CD dhe DVD (kushton më pak se sa materialet e bituara).<br>• Mund të përtrihen dhe ndryshohen pa bërë shpenzime plotësuese për botim dhe shpërndarje<br>• Mund të përmbajnë sasi të madhe të materialeve<br>• Mund të strukturohen në fusha me qëllim që të sigurohen informacione më të thella.<br>• Rinia i përdorin mediat digjitale kur janë të kapshme.<br>• Mund të përdoren për tejkalimin e llojllojshmërive të njerëzve në bashkësi. | • Nuk janë të kapshme për ata që nuk kanë DVD Pleer.<br>• Nuk janë të kapshme për personat të cilët nuk dijnë të përdorin kompjutorin.<br>• Mund të jenë të pakapshme për ata që nuk kanë qasje në internet |

## Programe mësimore, module dhe prezantime

Programet mësimore, modulet dhe prezantimet për trajnim janë mjete tradicionale për strukturimin e sasisë së madhe të diturisë dhe informacioneve në pako formale, standarde dhe të unifikuar. Informacionet kryesore shpesh herë duhet të barten nëpërmjet serisë së ngjarjeve, si për shembull, mbledhje, seminare, punëtori dhe uebinarë (seminare online), fillimisht të përgatitura për strukturimin dhe përkrahjen e trajnimit sy më sy për të punësuarit, vullnetarët, mësimdhënësit, studentët dhe anëtarët e bashkësisë. Elementet e reja, si për shembull, trajnimet interaktive, mësim nëpërmjet punës dhe rrjetëzimit social, prirje mund t'i bëjnë më të kënaqura, më të rëndësishme dhe më efektive.

Ky lloj i materialeve zakonisht dizajnohet për:

- Përkrahje të mësimit participues gjatë udhëzimeve të cilat jepen sy më sy
- Përkrahje të facilitimit gjatë intervenimeve më bashkësi
- Sigurimin e udhëzimeve individuale të përdoruesve.

## Prezantime

Prezantimet mund të jenë shumë të thjeshta dhe t'i zbatojë folësi me ndihmën e nkartelave, letër flip çart apo tabelë për të shkruar, me prozhektor apo nëpërmjet programit pëpr prezantim dhe me ndihmën e video materialeve. Ato mund të jenë efektive si hyrje të pavarura në tema të caktuara por gjithashtu mund të dizajnohen si pjesë e programit të caktuar mësimor.

## Module për trajnim

Modulet për trajnim janë dizajnuar të shkojnë një nivel më largë prej nivelit hyrës. Modulet më të mira për trajnim janë modulet e ndryshme për ndihmë të parë dhe shëndet në bashkësitë të cilat përdoren në të gjithë botën si dhe më shumë module për trajnim në fushën e gatishmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave. Moduli për mjerushmëri dhe vlerësim të kapaciteteve është i shtrirë gjërë dhe i janë bërë përshtatje të caktuara në rajone të ndryshme në botë.

Disa shoqata nacionale (siç janë Kryqi i kuq i Kamboxhës dhe Filipinit) kanë kurse standarde për orientim për uljen e rreziqeve nga katastrofat dedikuar për vullnetarë dhe të punësuar, ndërsa disa shoqata nacionale tjera gjithashtu kanë përgatitur module për integrimin e aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat në bashkësi. Në disa raste modulet janë të kapshme vetëm për pjesëmarrës të regjistruar për trajnim të caktuar.

Modulet për trajnim gjithashtu përgatiten për përkrahjen e kuadrove mësimore që punojnë në ngiritjen e vetëdijes për katastrofa në shkolla.

Shumë e më shumë ndërmerren orvatje sistematike për ndarjen e moduleve me kualitet të lartë për trajnim të cilat do të munden në mënyrë adekuate të përshtaten në mjedise të caktuara. Për shembull, qendra rajonale për edukim në bashkësi për preventivë nga katastrofat ka shpallur 30 module edukative në gjuhën spanjolle, portugale dhe angleze.

Disa prej moduleve të cilat fillimisht u dizajnuan për edukim në bashkësi, apo për zbatim joformal në shkolla, kaluan një fazë më lart dhe u bënë pjesë e resurseve që janë pjesë e programit formal më[simor. Materialet në kuadër të programit mësimor të cilat formalisht duhet të miratohen në shkolla, duhet të plotësojnë kritere plotësuese. Për shembull:

- Vëllimi i renditjes, për identifikimin e spektrit të gjërë të diturive, aftësive dhe kompetencave të cilat duhet të mësohen në një vit të caktuar shkollor.
- Pajtueshmëri me programin ekzistues mësimor, me qëllim që të identifikohen gjëra adekuate të cilat duhet të futen në programin në kuadër të një lënde të caktuar dhe vit shkollor.

Materialet në programet mësimore tani më janë përgatitur që të integrohen në programet mësimore shkollore në Svazilend, Mozambik dhe Angolë me të cilat përfshihen 6 rreziqe të mëdha rajonale. Në Vietnam materialet e para për siguri gjatë vërshimeve dhe tajfuneve janë përgatitur në vitin 1990 për fëmijë në klasën e 4 dhe të 5-të.

Këto materiale i kanë përdorur gjysëm miljon nxënës dhe falë tyre janë shpëtuar shumë jetë gjatë evakuimeve masive të suksesshme gjatë tajfuneve. Këto materiale tani përsëri mbindërtohen. Gjithashtu programi mësimor i shoqatës nacionale në Fixhi është miratuar nga Ministria e arsimit.

Në Kanada, programi i shoqatës nacionale i ahstuquajtur *Priteni të papriturën,* paraqet masa për uljen e rreziqeve nga katastrofat më të ndryshme që janë përpunuar në 3 libra:

- *Mund të ndodhë, Rrini gati* (për fëmijë të moshës 7 dhe 8 vjet).
- *Në pritje të të papriturës, Rrini gati* (për fëmijë të moshës prej 10 deri 11 vjet).
- *Rrini gati, Rrini në të sigurt* (për fëmijë të moshës prej 12 deri 13 vjet

Deri në vitin 2008, programi përfshiu 750.000 fëmijë.

Kryqi i kuq i Kanadasë gjithashtu përgatiti publikimin, i cili më vonë u përshtat edhe në SHBA. Publikimi u emërua *Ballafaqimi me Frikën* dhe u dizajnua për fëmijët e moshës prej 5 deri 16 vjet më mirë të prëgatiten për katastrofa pas sulmit terrorist të 11 Shtatorit 2011 në Uashington. Ky material tani është pjesë e programit mësimor për studime master për katastrofa në SHBA.

Tabela 13 më poshtë i paraqet përparsitë dhe sfidat lidhur me përdorimin e programeve mësimore, modulet dhe prezantimet.

## Tabela 13: Përparsi dhe sfida të programeve mësimore, moduleve dhe prezantimeve

| Përparsi | Sfida |
|---|---|
| • Sigurohet vëllim logjik dhe gjithëpërfshirës si dhe renditje për sasi të madhe të informacioneve.<br>• Vërtetohet kualitet dhe vijueshmëri në sigurimin e shërbimeve.<br>• Sigurohet bazë e përbashkët për të punësuarit dhe vullnetarët.<br>• Janë të kapshme në formë të shtypur apo digjitale. | • Botimi i tyre mund të kushtojë shumë para.<br>• Prezantimi i tyre sy më sy mund të kushtojë shumë para.<br>• Programet për trajnim mund të mos përfshijnë numër të madh të njerëzve si rezultat i periudhës kohore dhe lokacionit të njerëzve. |

## E-mësim

Trajnimi i cili bazohet në kompjutorë (për të cilin nevojitet kompjutor dhe DVD) apo trajnimi i cili bazohet në qasje ueb faqe (për të cilin ka nevojë për kompjutor dhe qasje në internet) janë dy mjetet kryesore për qasje në E-mësim. E-mësimi është studiuar shumë edhe në arsimin e lartë edhe në biznes tregohet se studentët të cilët mësojnë online në fakt tregojnë rezultate më të mira se sa nxënësit të cilët vizitojnë kurse klasike sy më sy.

Beneficionet kryesore të E-mësimit, aty ku ka qasje në internet dhe që është me çmime të kapshme janë:

- Qasje fleksibile 24/7, për mësimin e materialeve.
- Mundësi për ligjërues të kalibrit të lartë të cilat mund të ndajnë dituri në numër të madh të njerëzve.
- Opcion për mësim të pavarur me shpejtësi që i përgjigjet nxënësit dhe në pajtueshmëri me mundësitë individuale.
- Qasje në tekst, audio dhe video materiale në modalitete të ndryshme për mësim (varësisht nga mundësia e individit që më mirë të absorbojë dituri nëpërmjet mjeteve audio, vizuele, tekstuale dhe të filmuara).
- Çmimi i ulët i kostos.

Në dekadën e fundit E-mësimi zhvillohet shpejtë. Prodhimet fillestare të E-mësimit të njohura si program mësimor nga gjenerata e parë, sigurojnë hap pas hapi mësim strukturorsë bashku me pako lineare për mësim të kontrolluara nga mësimdhënësi, shpesh të shoqëruara me elemente audfio vizuele (për shembull, sllajd shou digjital). Teoria dhe praksa ngelen të ndara. Këto qasje lineare akoma funksionojnë mirë në bazë të përmbajtjes ku përshtatshmëria, standardet dhe posedimi i aftësive jenë me rëndësi esenciale.

Qasja e mëvonshme e njohur si programi mësimor e gjeneratës së dytë, prodhon rrjedhje të lirshme të mësimit, që udhëheqet sipas intereseve dhe nevojave të nxënësit. Struktura është në shtresa të ndryshme, ashtu që nxënësit mund të futen thellë në cilën do qoftë të sferave varësisht interesit të tyre. Evaluimi bazohet në vetvlerësim, orvatje të njëpasnjëshme dhe praktikim reflektiv të përmbajtjeve.

Këto qasje të cilat bazohen tek nxënësi funksionojnë posaçërisht mirë aty ku përparësi kanë zbulimi, të menduarit thelbësor, zhvillimi i udhëheqjes, fleksibiliteti dhe zgjedhja e problemeve. Metodat e të mësuarit të bashkohen. Sistemet e gjeneratës së dytë mund të sigurojnë lidhje mes vetmësimit dhe mësimit të bazuar në nevojat projektuese. Rezultatet e mësimit mund të maten dhe përcjellen, ndërsa realizimet mund të njihen dhe dituritë të merren dhe ndahen në kuadër të bashkësive të caktuara për mësim.

Programi mësimor për E-mësim mund të bazohet në vëllim të gjërë të përmbajtjeve, mes cilave:

- Mësime (nëpërmjet mësimit sipas shpejtësisë personale dhe kohës së lirë të nxënësit)
- Aktivitete dhe lojëra interaktive
- Kuize dhe teste (në forma të ndryshme të cilat automatikisht vlerësohen)
- Klibe audio dhe video.
- Diskutime të sinkronizuara (klasa dhe biseda virtuale) dhe të asinkronizuara (forume) nëpërmjet të cilave komunikojnë bashkësitë online, me klasa virtuale për të cilat duhet facilitim.
- Mjete siç janë bllog dhe vikis, për marrjen dhe ndarjen e diturive.
- Tutorizimi, mësimi, mentorimi, facilitimi nëpërmjet opcioneve online dhe offline.
- Administrim dhe përcjellje (kyçur edhe certifikimin).

Njëra prej beneficioneve kryesore të programit mësimor për E-mësim është potenciali për përdrimin e sërishëm dhe adaptimin e përmbajtjes për E-mësim.

Gjatë dekadës së fundit disa shoqata nacionale kanë përgatitur module për trajnim të cilat janë të kapshme në video formate si dhe format për vetmësim përpunuar në CD. Ekziston interes swhumë e më shumë që shumë module për trajnim të konvertohen në E-mësim formate të cilat mund të barten në CD, DVD apo online.

Për momentin Federata ndërkombëtare punon në pilotimin e sistemit për menaxhimin e mësimit i cili mundëson integrimin e më shumë programeve për trajnim. Sistemi quhet NJË KRYQI I KUQ, dhe ka për qëllim që t'ju mundësojë vullnetarëve mësim gjithëpërfshirës – posaçërisht në fushën e ndihmës së parë dhe përgjigje gjatë katastrofave. Për popullatën e përgjithshme gjithashtu është i kapshëm kursi prej 20 minutave për vetmësimpër gatishmëri për H1N1.

Kryqi i kuq i Amerikës për momentin piloton programë për rangim për kompani dhe organizata tjera, kyçur edhe shkollat. Qëllimi i programit është trajnimi për gatishmëri gjatë katastrofave dhe përkrahja drejtpërdrejtë të cilën e sigurojnë organizatat komunale të Kryqit të kuq.

Tabela 14 më poshtë paraqet përparsitë dhe sfidat e E-mësimit.

## Tabela 14: Përparsi dhe sfida të E-mësimit

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Efektive njëjtë si he mësimi në shkolla<br>• Shpenzime më të ulëta për person se sa mësimi në shkolla. | • Nevojitet qasje në DVD pleer apo kompjutor.<br>• Nevojitet qasje në internet për funksionim të plotë. |

| | |
|---|---|
| • Ekspertiza është e kapshme në korniza të gjëra.<br>• Mësimi zhvillohet sipas shpejtësisë personale të nevojshme.<br>• Nuk varet nga koha dhe lokacioni.<br>• Mund të lidhet me projekte lidhur me ndërmarrjen e një aksioni të caktuar.<br>• Rezultatet mund të përcjellen në korniza të gjëra. | • Përgatitja e planit mësimor për e-mësim obligon pajisje të re të aftësive dhe mjeteve.<br>• Platforma zhvillimore fleksibile dhe participative mund të jetë komplekse dhe të kushtojë shumë për zbatimin e saj.<br>• Më pak është shoqëruse, përveç nëse nuk organizohet për interaksion grupor mes personave apo në formë elektronike.<br>• Nevojitet më pak personel për shkak të interaksion më të vogël apo më të largët. |

## Shfaqe dhe pika artistike

Shfaqet dhe pikat artistike sigurojnë spektër të gjërë të mundësive kreative për komunikimin e porosive të rëndësishme, serioze, nëpërmjet përvojave të pasura, të prezantuara shpesh drejtpërsëdrejti.

Shembuj për këto janë:

- Teatri në rrugë, lecimet e dramave, skeçe dhe shfaqe.
- Shfaqe me kukulla.
- Lexime poetike.
- Vallëzime.
- Aktivitete fleshmob në mjedise të mëdha urbane (grup njerëzish të cilët përnjëherë mbnlidhen në vende publike, prezantojnë vepër të pazakonshme dhe pastaj shkojnë).
- Tregim i përrallave, në shoqërim të muzikës dhe këndimit.
- Punëtori kreative.

Në të gjitha këto aktivitete janë kyçur vullnetarë dhe anëtarë të bashkësisë, si prezantues apo si publikë. Prezantuesit e aftë gjejnë mënyra kreative që ta mbajnë interesin e publikut.

Shfaqet dhe pikat artistike mund të përdoren në rrethin ku njerëzit tubohen për ndonjë qëllim nëpërmjet: pikave informative në panaire, ekspozita, ngjarje në rrugë dhe ngjarje publike në paqe. Posaçërisht, rinia shpesh herë janë të gatshëm të angazhohen në ngjarje të tilla.

Përderisa kyçet edhe elementi i caktuar garues, kjo mund të nxisë edhe më shumë njerëz. Është shumë me rëndësi të mbahet mend se secilit që merr pjesë duhet t'i tregohet respekt dhe t'i jepet mirënjohje.

Në Argjentinë, u organizua menifestim në parkun e qytetit që të ngritet vetëdija për rreziqet nga vërshimet, ndërsa në Filipine u organizua shfaqe teatrale që të tregohet në ndërtimin e ndërtesave rrezistuese në katastrofa. Në Kolumbi, Kryqi i kuq përgatiti këngë për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Tabela 15, më poshtë paraqet përparësitë dhe sfidat e prezantimeve dhe shfaqeve teatrale.

## Tabela 15: Përparësi dhe sfida të prezantimeve dhe shfaqeve teatrale.

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Argëtim, tërhjekin popuj, prezantojnë mundësi të mirë për ngritjen e vetëdijes për tema serioze të cilat njerëzit zakonisht mundohen t'i tejkalojnë.<br>• Mundësi e pafund për kreativitet.<br>• Vullnetarët e rinj kënaqen në udhëheqjen e aktiviteteve të tilla. | • Porositë mund të humben.<br>• Mund të duhen mjete plotësuese për bartjen e porosive të qarta.<br>• Mosformaliteti mund të paraqet sfidë për rritjen e vëllimit të aktiviteteve. |

## Lojëra dhe gara

Lojërat dhe garat ofrojnë mundësi shpesh herë njohur me termin “Argëtim edukativ”. Mund të përgatiten lojëra në tabela për grup të vogël të njerëzve në lloj të ndryshëm të materialeve apo të vizatohen në oborret e shkollave në asfalt që të tërhiqet vëmendja e nxënësve.

Pikat artistike gjithashtu mund të organizohen në mënyra garuese, mes shkollave që të maksimalizohet kyçja e nxënësve. Mund të organizohen gara për përpunimin e posterit më të mirë, kontrollim të diturive nëpërmjet kuizeve, shkruarje tëeseve, këngëve, poezive, pikave artistike apo slloganeve me qëllim që garat të jenë akoma më interesante.

Gjithmonë kur fëmijët dhe rinia përgatisin punimet e tyre, kjo është garanci se do të tërhiqet vëmendja eedhe e prindërve por edhe e anëtarëve në bashkësi. Radionet dhe televizionet shpesh herë me sukses përdoren për transmetimin e garave apo për të informuar opinionin për mbajtjen e tyre.

Lojërat gjithashtu mund të jenë jashtzakonisht efektive kur bëhet fjalë për të rritur të cilët gjithashtu angazhohen dhe mësojnë më shumë kur e përdorin tërë trupin e njëkohësisht edhe argëtohen. Kjo mund të jetë e organizuar në forma më të thjeshta me pjesëmarrje të të moshuarve në aktivitete të caktuara fizike me natyrë garuese, si për shembull hudhje dhe kapje të topit dhe dhënien e përgjigjes për pyetje të caktuar.

Ose në formë të interpretimit të roleve, zgjedhje të problemeve dhe simulimeve. Këto "lojëra serioze" tregohen si shumë efektive kur bëhet fjalë për mësimin e informacioneve të caktuara komplekse. Akoma ka nevojë për punë në këtë lëmi, posaçërisht në grumbullimin e shembujve për orvatje inovative të cilat mund të replikohen si dhe në bazë të testimit të rezultateve nga këto aktivitete.

Për garuesit, pjesë e argëtimit është që të shkohet me mjete dhe shpërblime stimuluese. Njerëzit gjithmonë dëshirojnë të fitojnë diçka, pa dallim se sa janë ato të thjeshta, prandaj vullnetarët dhe opinioni kënaqen kur fitojnë maicë, kapelë, bylyzyk apo suvenir tjetër. Është shumë me rëndësi që këto prodhime të mos e ndotin natyrën dhe të jenë me kualitet të mirë dhe të sigurojnë mundësi për bartjen e porosive edukative. Prodhime të tilla mund të jenë:

- Ngjitëse
- Tatu të cilat shlyhen
- Bukmarkerë
- Stilolaps, lapsa dhe goma
- Bexhe dhe shenja

Gjëra më të shtrenjta për individë, familje apo bashkësinë mund të jenë:

- Gota të mëdhaja
- Torba
- Mbulesa dekorative
- Lojëra me letra
- Pajisje për ndihmë të parë
- Poçe me bateri
- Çanta për evakuim
- Megafonë
- Radio me sjellje

Shpeshherë kompanitë janë të gatshme të dhurojnë mjete për blerjen e prodhimeve të tilla. Për garat e mëdhaja mund të parashikohen edhe shpërblime siç janë telefona dhe aparate.

Për ngritjen e vetëdijes për qëllime të caktuara mund të përdoret organizimi i lotarive dhe tombollave.

## Tabela 16: Përparësi dhe sfida që kanë të bëjnë me lojërat dhe garat

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Ato janë participuese, angazhuese dhe motivuese.<br>• Stimulojnë zgjedhjen e problemeve<br>• Stimulojnë dialog moshatar.<br>• Përmirësim të hasjes dhe mbajtjes së diturive.<br>• Mirë për kapjen me çytje komplekse dhe të hapura.<br>• Garat mund të bashkojnë njerëz në pjesë të madhe gjeografike<br>• Për lojërat online apo lojërat kompjuterike nuk ka nevojë të ndahen të holla të larta, e mund të angazhohen njerëz për qëllim të njëjtë në distanca të mëdha. | • Ka nevojë për studim dhe dizajnim me kujdes.<br>• Ka nevojë të jenë argëtuese<br>• Lojërat reale dhe simuluese mund të kushtojnë shumë para për përgatitje dhe testim.<br>• Për lojërat kompjuterike nevojitet numër i madh i kompjutorëve për pjesëmarrësit. |

## Audio dhe video materiale

Ekziston vazhdimësi në audio dhe video produksion. Nga njëra anë ekzistojnë prodhime profesionale të prodhuara ku porositë kontrollohen në sasi të madhe. Nga ana tjetër ekzistojnë video participuese, që prodhohen në mënyrë individuale apo kolektive me material spontan me përdorimin e video kamerave të lira dhe pajisjeve për gjirim.

Videot e përgatitura profesionale janë të rëndësishme për dokumentim, komunikim donator dhe marrëdhënie me publikun, përderisa video produksionet më joformale mund të jenë mjete të rëndësishme për plotësimin e diturive, stimulimin e kreativitetit lokal, ndarje të storjeve dhe promovim të edukimit moshatar. Në rastin e videove participuese, procesi i prodhimit bëhet përvojë edukative ku qëllimi primar është të stimulohet dialog lokal dhe zgjedhje e problemeve.

Audfio porositë dhe televizionet kanë mundësi të madhe pa hamendje për diseminimin e informacioneve pothuajse në çdo familje. Deri tani prodhimi dhe shpërndarja ishin vetëm në duart e pronarëve publik apo privat, prandaj shoqatat nacionale kishin kontrollë të vogël ndaj përmbajtjes. Megjithatë, kjo fotografi ndryshohet për shkak se prodhimi i materialeve të tilla bëhet e thjeshtë dhe kushton më pak, e tani ekzistojnë edhe kanale plotësuese për shpërndarje me potencial të jashtzakonshëm.

Tre lloje kryesore të audio dhe video produksioneve dallohen sipas gjatësisë, kanaleve për shpërndarje dhe profesionalitetit të produksionit:

- Shpallje të shkurta radio dhe televizive (spote)
- Prodhime të shkurta audio dhe video
- Produksione të gjata audio dhe video

Secili prej këtyre janë sqaruar më poshtë në më shumë detaje.

## Shpallje radio televizivetë shkurta

Në shumë vende mediat masive sigurojnë porosi deri tek opinioni nëpërmjet serviseve publike në bazë vullnetare si kontribut për përgjegjësi shoqërore. Spotet në mënyrë tipike janë në kohëzgjatje prej 20, 30 apo 50 sekonda.

Ato patjetër duhet të jenë të shkurta dhe lehtë të mbahen mend dhe iu bëjnë me dije njerëzve se si të arrijnë në më shumë informacione (me shkruarjen e numrit të telefonit apo e-mailit e cila mundet lehtë të mbahet mend. Është shumë lehtë të sigurhen zëra të personave të njohur, të përgatiten sllogane të mira dhe të jenë të përcjellura me ton dhe muzikë të këndshme dhe pozitive.

Dizajnuesit profesional dhe ekspertët për komunikim mund të japin kontribut të posaçëm në përgatitjen e spoteve tuaja, por sot mund edhe vet të përgatitni spote kualitative, apo të adaptoni resurse ndërkombëtare apo nacionale, vetëm me përkrahje të vogël të vullnetarëve.

Koha më e rekomanduar për prezantimin e spoteve është në periudhat goditëse të ditës, zakonisht pasi të mbarojë dita e punës, zakonisht para lajmeve të mbrëmjes. Spotet e përgatitura mirë për çështje sociale të rëndësishme mund të bëjnë ndryshim të madh, prandaj është mirë të keni raporte të ndërtuara mirë me mediat.

Në tabelën 17 më poshtë janë paraqitur përparsitë dhe sfidat lidhur me shpalljet e shkurta radiotelevizive (spote).

## Tabela 17: Përparsi dhe sfida të spoteve

| Përparsi | Sfida |
|---|---|
| • Qasje në opinionin e gjërë, në publikun qëllimor.<br>• Porosi bijuese standarde.<br>• Tërheqin vëmendje dhe njihen lehtë.<br>• Zakonisht mund të nënshkruhen të emitohen pa pagesë.<br>• Mund të përgatiten varësisht nga koha vjetore dhe rreziku.<br>• Mund të përgatiten për paraqitje serike për qëndrueshmëri të intervenimit.<br>• Mund të inspirohen njerëzit të kërkojnë më shumë informacione. | • Mund të paraqiten më vonë gjatë natës apo në shemën e tyre.<br>• Patjetër të mendohen mirë që të jenë efektive.<br>• Mediat mund të mos duan t'i shpallin pa pagesë nëse në ato shohin si në mjete të të hyrave. |

## Porosi për paralajmërim të hershëm: tregime kyçe

- **Burimi –** është me rëndësi të vërtetohen sisteme të sigurta komunikative me linja të qarta të komunikimit. Megjithatë, mos u mbështetni vetëm në një burim pa marë parasysh se sa është i sigurt – në vend të kësaj, keni grupin e burimeve të besueshme, me të cilin mund t'i kontratoni porositë për paralajmërim të hershëm.
- **Përmbajtja –** keni kujdes që porositë të përshkruhen saktë kush, çka dhe kur do të bëjë.vizatoni pikturë të thjeshtë dhe jeni specifik. Sqaroni pasojat të cilat mund t'i sjellë rreziku i drejtpërdrejtë.
- **Stili –** jeni të qartë, përdorni fjalë të thjeshta pa zhargon. Jeni preciz dhe pa hamendje. Atë që do ta thoni, thoni me siguri. Tregoni se ekziston mundësi e madhe që ngjarja të ndodhë dhe të gjithë menjëherë duhet të veprojnë.
- **Saktësi –**mendoni se çka do të kuptojnë njerëzit nga porosia juaj.
- **Vijueshmëri –** Jeni të vijueshëm në porositë tuaja. Mos shpallni porosi të cilat janë kontradiktore njëra me tjetrën apo të nxisni konfuzion.

## Audio dhe video prodhime të shkurta

Këto prodhime audio, vizuele apo multimediale zakonisht janë të inçizuara paraprakishttë cilat shpërndahen nëpërmjet internetit në plejbek apo kompjutor. Këto audio dhe video prodhime zgjasin më pak se 5 minuta dhe shpesh i shohin përdoruesit e kompjutorëve me internet qasje gjatë pauzave të shkurta, deri sa lexojnë e-mail apo i shfletojnë mediat sociale. Prodhimet e gjata audio (të cilat zgjasin më shumë se 10 minuta), shpesh herë shkarkohen nga interneti që të

dëgjohen në audio pleerë. Pa dallim të zgjatjes së tyre ato duhet të jenë të shtesë dhe ta tërhjekin vëmendjen e të gjithë publikut.

youTube, mjeti më i popullarizuar për shpërndarjen dhe shikimin e video prodhimeve (www.youtube.com), ofron disa karakteristika të dobishme, si për shembull:

- E tregon gjatësinë e videos dhe numrin se sa herë është shikuar.
- Iu mundëson shkiuesve ta shtojnë videon në plejlistën e tyre dhe ta ndajnë me njerëzit tjerë.
- Shikuesve iu jep mundësi për komente dhe rangime të videove, që iu mundëson rangim sipas popullaritetit dhe numrin e vizitave.

Megjithatë, YouTube nuk është i kapshëm në disa vende. Kjo do të thotë se ka nevojë të gjenden mundësi alternative për shikimin e videove.

Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe ka 3 Youtube kanale me qindra video. Deri në fund të vitit 2009, një prej kanaleve kishte 75.000 shikime. Gjithsej 750.000 video janë shikuar dhe 1000 persona u bënë parapagues të kanalit. Video më e shikuar është shikuar 130.000 herë. Disa prej videove më të shikuara janë ndërtimi i shtëpive prej bambusi në Indonezi dhe si të ndërtohet shëtpi më e sigurtë prej druri e cila do të jetë rrezistente nga uraganët. Vullnetarët e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe gjithashtu e përdorin Youtuben për aploadime të shkurta të video përmbajtjeve të shkurta.

Ndonjë prej shembujve më të suksesshme janë ato të të rinjve të Kryqit të kuq të Kolumbisë, gjegjësisht porositë tek opinioni për mbrojtjen e mjedisit jetësor që emitohet në “Un minuto al Aire” (një minutë në etër). Shembull i mirë është gjithashtu edhe videoja e Kryqit të kuq të Argjentinës “Casa inundada” (shtëpia e vërshuar). (www.youtube.com/watch?v=5bZKCT7aonE).

Video gjithashtu mund të shikohen në shumë internet faqe të shoqatave nacionale dhe Federatës ndërkomëbtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Kryqi i kuq i Spanjës dhe Rajoni Karibian kanë ueb faqe të posaçme me video të cilat ofrojnë spektër të gjërë të porosive të mira për uljen e rreziqeve nga katastrofat.

Video participative është posaçërisht mjet efektiv për përdorim në bashkësi ku pushtetet dhe sektori joqeveritar kanë bashkëpunim të afërt. Bashkësive më të mjeruara iu mungon udhëheqja e mirë. Video dhe audio produksionet iu mundësojnë këtyre grupeve të dëgjojnë porosi me zërin e tyre të cilat mund t'i përforcojnë dhe të arrijnë tek ato në mënyrë më efektive.

Tabela 18 më poshtë i paraqet përparësitë dhe sfidat e audio dhe video prodhimet e shkurta.

## Tabela 18: Përparësi dhe sfida të audio dhe video prodhimeve të shkurta

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Mundet shpejtë dhe lehtë të përgatiten dhe ripërtrihen.<br>• Mund të shpërndahen nëpërmjet internetit.<br>• Mundet lehtë të shpërndahen nëpërmjet rrjeteve sociale.<br>• Audio prodhimet mund të diseminohen nëpërmjet radios.<br>• Mund t'i kuptojnë edhe analfabetët.<br>• Mund të përgatiten me pjesëmarrjen e shumë partnerëve.<br>• Prodhimi i tyre nuk kushton shumë.<br>• Mund të jenë pjesë e serialeve apo kanaleve.<br>• Mund të çojnë deri në njohjen e shumë gjërave të rëndësishme.<br>• Mund të jenë relevante dhe bashkëkohore.<br>• Mund të bartin shembuj në detaje dhe ushtrime treguese.<br>• Të përshtatshme janë për komunikim moshatar në largësi të mëdha.<br>• Video prodhimet janë të përshtatshmeedhe për personat me pengesa në dëgjim (me interpretim me shenja).<br>• Ata janë mjet i respektuar tek gjenerata e re. | • Patjetër duhet me kujdes të kontrollohen që të tejkalohen hamendje apo informacione të gabuara – proces në të cilin ndonjëherë nuk i kushtohet mjaft vëmendje në këtë medium.<br>• Patjetër të jenë mirë të përgatitur që të jenë efektive.<br>• Mund të jenë të injoruar.<br>• Ka nevojë për promovim nëpërmjet rrjeteve sociale.<br>• Për shpërndarje nevojitet planifikim me kujdes.<br>• Produksioni participues obligon trajnim, praksë, bashkëpunim dhe informacione kthyese. |

## Audio dhe video produksione më të gjata

Videot profesionale të përgatitura me të madhe përdoren për promovimin e aktiviteteve të lëvizjes, dhe tërheqin shumë donacione, dhe sigurojnë mbulimin dhe dokumentimin e projekteve apo çështjeve të rëndësishme. Njëra prej përdorimeve më inovative dhe më të suksesshme është seria e audio novelave, që u bënë shumë të popullarizuara në Amerikën latine "më mirë të ndërpritet se sa të shërohet" është seriali prej 25 episodeve. Në serial janë paraqitur rreziqet natyrore që ndodhin në Karibe. Një serial përbëhet prej 10 – 15 minutave për episodë.

Programet radio televizive të rregullta drejtpërdrejtë janë shumë të sukseshme në Ugandë. Tuvallu Organizata komunale e Kryqit të kuq ka programe të rregullta në radion nacionale ku emitohen porosi për përgatitshmëri gjatë katastrofave, kujdes shëndetësor, ndryshime klimatike, ruajtje të resurseve me ujë, gjatë sezonit të thatësirave. Përdoren edhe gara për ngritjen e vetëdijes tek fëmijët e moshës shkollore.

## Tabela 19: Përparësi dhe sfida tek audio dhe video produksionet

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Mund të emitohet e gjithë storja.<br>• Mund të rritet llogaridhënia.<br>• Radioja është kanal i kapshëm shpërndarës.<br>• Operat e sapunit janë më goditëse.<br>• Mund të jenë pjesë e radio emisioneve të rregullta.<br>• DVD pleerët për shikimin e tyare janë me çmim relativisht të ulët. | • Për shpërndarje në opinionin e gjërë nevojitet planifikim i mirë dhe shumë punë.<br>• Për videot nevojitet produksion profesional.<br>• Për radio emisionet e rregullta nevojitet planifikim i mirë dhe prezantues të mirë.<br>• Operat e sapunit obligojnë koncepte me kualitet të lartë, shkrim dhe përmbajtje. |

Për shkak se lëvizja është llogaridhënëse në bazë enorme, nevojitet që të përkushtohet vëmendje e madhe për përgatitjen e raporteve. Prandaj fotografitë dhe videot lokale paraqesin aspekt të rëndësishëm jo vetëm për shkak të dokumentimit të aktiviteteve por edhe për ngritjen e vetëdijes dhe përgatitjes së materialeve edukative. Prandaj me rëndësi të jashtëzakonshme është që videot shumë e më shumë përdoren gjatë përgatitjes së raporteve.

## Internet resurse

Njëra prej mënyrave më të thjeshta dhe më të lira për demonstrimin e transparencës, llogaridhënies dhe vijueshmërisë është përdorimi i internet faqeve të shoqatave nacionale për promovimin e edukimit të opinionit për uljen e rreziqeve nga katastrofat. Është shumë me rëndësi këto porosi të munden lehtë të gjenden dhe të jenë vetëm një klik larg faqes fillestare. Kjo do të thotë se promovimi dhe potencimi i aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat të jenë punë vijuese në të cilat janë kyçur të gjithë, me qëllim që informacionet të mos jenë të gropuara diku largë ku nuk do të jenë të kapshme për njerëzit.

Internet faqet janë mjete të cilat ju mundësojnë t'i shpërndani të gjitha resurset e kapshme. ato duhet të jenë mjet primar për shpërndarje për shoqatat nacionale për shpërndarjen e informacioneve në organizatat komunale dhe elementare, si dhe tek opinioni i përgjithshëm.

Shembuj të internet faqeve të pasura me resurse janë:

- http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/. – Që këtu keni qasje në numër të madh të resurseve. Gjithashtu mundet të keni qasje në DMIS (Sistem informativ menaxhues për katastrofa) në ueb faqen e re të Federatës ndërkombëtare (në këndin e djathtë lartë).
- http://www.ifrc.org/en/what-we-do/health/diseases/pandemic-influenza/your-best-defence-is-you/.– Internet faqja e Federatës ndërkombëtare për vbirusin H1N1 ku ka edhe modul të shkurtë për E-mësim, video postere dhe E-mjete.
- Qendra gjithëpërfshirëse resurse e Qendrës Rajonale Referente për edukim dhe gatishmëri gjatë katastrofave në Amerikë.
- www.climatecentre.org – Internet faqja e Qendrës klimatike, kyçur edhe pjesën speciale për të rinj të www.climatecentre.org/site/youth.
- www.informedprepared.eu – Internet faqja e shoqatave evropiane nacionale të Kryqit të kuq, në gjuhën angleze, françeze, gjermane, spanjolle, polake dhe turke të cilin e promovon sllogani universal “Të informuar. Të gatshëm. Së bashku”.
- http://pirac.scroix-rouge.fr – Faqja resurse e Kryqit të kuq të Francës, e cila ripërtrihet në Rajonin Karibian dhe paraqet mjet për ngritjen e vetëdijes për katastrofa natyrore – baza e të dhënave me materiale edukative nga i gjithë rajoni.
- Kryqi i kuq i Australisë e përdor ueb faqen e vet për shpalljen e materialeve të Kryqit të kuq të të Rinjve për çështje siç janë ndryshimet klimatike, me storje lokale dhe ndërkombëtare.
- http://adsoftheworld.com/media/online/red_cross_colombia_game– Kryqi i kuq i Kolumbisë bon orvatje pionere në postimin e lojës online për ngritjen e vetëdijes për dhurimin e gjakut.
- www.redcross.org – Kryqi i kuq i Amerikës përgatiti një mori faktesh për gatishmëri gjatë katastrofave në të cilat mund të qaset nëpërmjet ueb faqes.
- www.redcrossroommates.org/en–Organizata komunale Bej Eria e Kryqit të kuq të Amerikës ka përgatitur 6 episoda me animacione të thjeshta interaktive me çka përdoren 4 cimerë të cilët i ftojnë dhe përkrahin përdoruesit që të bëjnë planin e vet dhe të përgatisin kartelë e vet personale për në kuletë me informacione më të rëndësishme,

Në Tabelën 20 më poshtë janë paraqitur përparësitë dhe sfidat lidhur me përdorimin e internet faqeve.

## Tabela 20: Përparësi dhe sfida për përdorimin e ueb faqeve

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Baza e resurseve gjithëpërfshirëse<br>• E përmirëson llogaridhënien dhe transparencën<br>• Mund të përmbajë shumë verzione për publikun e ndryshëm qëllimor, gjuhë dhe materiale të cilat i rekomandojnë publiku qëllimor.<br>• Është përkrahur me mjete vizuele.<br>• Mund t'i përshkruajë resurset dhe të ftojë të parashtrohen pyetjet.<br>• Përdoruesit mund t'i përcjellin për marrjen e përmbajtjeve të reja.<br>• Mund të bëhet burim i besueshëm i informacioneve.<br>• Mund të kontribuojë për përmirësimin e profilit dhe rritjen e kredibilitetit. | • Nevojitet dizajn profesional përdorues – shoqëror.<br>• Duhet dizajn i mirë dhe mjete për shfletim dhe krëkim.<br>• Duhet plotësim i rregullt me përmbajtje të reja.<br>• Qasja mundet të jetë e vështirësuar si rezultat i vëllimit të vogël.<br>• Qasja mund të jetë e vështirë apo e shtrenjtë.<br>• Patjetër duhet të dizajnohet që të korrespondohet në shfletues të ndryshëm.<br>• Patjetër duhet të përshtatet të korrespondojë në pajisje mobile dhe në kompjutorë. |

## Media sociale

Mediat sociale janë të gjitha ato mjete që iu mundësojnë njerëzve të komunikojnë dhe të rrjetizohen pa iu nevojitur përkrahje tradicionale organizative. Ato mund të përdoren për ndërtimin e besimit dhe kohezionit dhe përkrahjes mes veti. Rregullimi në komunikimin digjital mundëson në mënyrë të lehtë dhe të lirë të formohen grupe të njerëzve të cilët shpërndajnë gjëra dhe punojnë për qëllime të përbashkëta.

Grupe të vogla dhe të mëdha për shpalljen e informacioneve, bashkëpunim, shpërndarje të diturive, shpërndarje në multimedia dhe vlerësim kolektiv lehtë të menaxhohen, dhe mundësojnë eksperimentim me qëllim që të shihet se çka funksionon më së miri. Edhe pse rinia i marrin këto forma si diçka e zakonshme, ato bëhen mënyrë sa më e rëndësishme për ngritjen e vetëdijes së opinionit dhe edukimin e publikut.

Në Tabelën 21 më poshtë janë paraqitur lloje të ndryshme të mediave sociale dhe përparësitë dhe shembujt e tyre.

## Tabela 21: Përparësi të mediave sociale dhe shembujve

| Lloji | Dobishëm për | Shembuj |
|---|---|---|
| E-mail | Komunikim individual dhe në grupe | www.ifrc.org, shoqata juaj nacionale |
| Listservs | Komunikime masive e-mail, buletine | Rrjet për katastrofa dhe qëllime tjera të caktuara |
| Rrjete sociale | Emitim i sinkronizuar, | Facebook, Myspace, LinkedIn |

| | | |
|---|---|---|
| | shpërndarja e mediave, rrjete me miq | www.facebook.com www.myspace.com www.linkedin.com |
| Bllog dhe forume për diskutime | Diseminime të mendimeve, lajme, çështje dhe diskutime | www.blogspot.com www.wordpress.com |
| Bashkësia të moderuara për praksa specifike | Nxjerrje dhe regjistrim të përvojave në praksa të caktuara. | KB – Indi Këmbimi i zgjedhjeve |
| Bashkësi | Lidhje rrjetore të mjedisit të caktuar gjeografik | Ning www.ning.com |
| Përmbajtja, prodhimi i grupit të caktuar | Filtrim dhe rritje e porosive, rekomandime bazuar në "Mençurinë e grupit". | Digg www.digg.com |
| Bukmarkerë social | Shpërndarje dhe bashkim i foto resurseve | Del.i.cio.us, drrlibrary.com www.del.i.cio.us.com www.drrlibrary.com |
| Shpërndarja e fotografive | Sigurim, organizim dhe bashkim i foto resurseve | Flickr, picassa www.flickr.com – www.picassa.google.com |
| Wiki | Autorizim kolektiv | Wikipedia, google www.wikipedia.org www.docs.google.com |
| Shpërndarja e videove | Shpërndarje, organizim, filtrim i videove | YouTube, Ted Video www.youtube.com www.ted.com |
| Lokacioni | Mbledhje dhe aksion në lokacion të caktuar | Meet-up, Doodle, Flashmob, Tripit www.meetup.com www.doodle.com www.flashmob.com www.tripit.com |
| Mikromedia dhe SMS | Tekst porosi masive | Twitter, Twhirl www.twitter.com www.twhirl.org |
| Porosi me fjalë | Porosi me zë të kërkimeve | IVRS |
| Shpërndarje e dokumenteve dhe programeve | Shpallje dhe shpërndarje të dokumenteve, prezantimeve dhe kurseve | Scribed, Slideshare, Open Courseware Consortium www.scribed.com www.slideshare.net www.ocwconsortium.org |

Federata ndërkombëtare dhe disa shoqata nacionale filluan të shfrytëzojnë media sociale për ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të opinionit. Fushata e Federatës ndërkombëtare – ju jeni në rradhë, memomentalisht është e pranishme në Facebook, YouTube, Flickr dhe Twitter. Rinia e Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe njësoj e përdorin Facebook-un dhe Twitter-in. Në këtë mënyrë vullnetarët e rinj shpërndajnë porositë e organizatës me rrjetet e veta sociale.

Në tabelën 22 më poshtë janë paraqitur përparësitë dhe sfidat e mediave sociale.

## Tabela 22: Përparësi dhe sfida për mediat sociale

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Kanale shpërndarëse me kapacitet të madh – si për shembull Facebook dhe Twitter.<br>• Shpërndahen – angazhohen vullnetarë dhe shpërndahen përcoja.<br>• Ka fuqi ta drejtojë komunikacionin në resurse tjera, si për shembull internet faqe për fushata, internet faqe, bllog dhe statuse.<br>• Mundësojnë komunikim të rregullt që kontribuon në zhvillimin e raporteve.<br>• Mundësojnë shpërndarje të rregullt të informacioneve të shkurta. | • Përmbajtjet patjetër rregullisht të ripërtrihen.<br>• Nevojitet sistem për informacione kthyese për interaksion me publikun.<br>• Nevojitet hapërim hap pas hapi me teknologjinë.<br>• Patjetër të ndahet kohë dhe kreativitet. |

## Telekomunikacione

Aktivitetet e telekomunikimit ofrojnë spektër të gjërë të mundësive. Sistemet e automatizuara mund të përshtaten të dërgojnë porosi me tekst dhe për pranimin e porosive të caktuara të inçizuara. Informacionet e telefonit dhe sistemet për dërgimin e porosive akoma nuk përdoren shumë në lëvizje edhe pse ka pilot projekt të mirë në Shri Lankë që fokusohet në sistemin për paralajmërim të hershëm bazuar në këtë medium.

Dërgimi i porosive është shumë me rëndësi për sigurimin e alarmimit të popullatës nëpërmjet pranimit të porosive për paralajmërim të hershëm. Ky sistem gjithashtu mundet rregullisht të përdoret dhe testohet edhe me lloje tjera të porosive për përgatitje gjatë katastrofave. Sistemi i njëjtë përdor sistem interaktiv me zë për përgjigje i cili u mundëson përdoruesve të paraqiten, selektojnë një ndër opcionet dhe të marrin informacion paraprakisht të inçizuar. Thirrësit fillimisht zgjedhin gjuhën e pastaj zgjedhin një prej temave në të cilat paraprakisht janë inçizuar porosi të cilat përmbajnë informacione specifike të cilat dëshirojnë t'i dëgjojnë njerëzit të cilët e realizojnë thirrjen.

Teknologjia funskionon nëpërmjet serverit lidhur me internet me të cilin mund të drejtohet prej kudo. Ata të cilët pranojnë porosi të tilla regjistrohen (ose në grupe ose në mënyrë individuale). Numri i telefonit për porosi të tilla mund të diseminohet si burim i ër personat të cilët kërkojnë informacione.

Tabela 23 më poshtë paraqet përparësitë dhe sfidat lidhur me përdorimin e mjeteve tël telkomunikimit.

## Tabela 23: Përparësitë dhe sfidat lidhur me telekomunikacione

| Përparësi | Sfida |
|---|---|
| • Eliminohet nevoja për bisedë të drejtpërdrejtë<br>• Janë të kapshme 24/7, pothuajse gjithkund.<br>• Numri i telefonit mund të shpërndahet si linjë tag.<br>• Është e kapshme edhe për njerëz të cilët nuk dijnë të lexojnë.<br>• Mund të krijohen në numër të ndryshëm të gjuhëve.<br>• Shpenzimet e ulta do të thonë dërgim i porosive në shumë gjuhë.<br>• Porositë për paralajmërim të hershëm mund të verifikohen nga burime të besueshme.<br>• Porositë mund të jenë të shkurta dhe në pajtueshmëri me nevojat individuale.<br>• Gjatë katastrofave dhe situatave emergjente kjo munet dukshëm ta ulë angazhimin e organizatave.<br>• Rrjetet sociale mundësojnë llogaridhënie dhe transparencë më të mirë. | • Nevojiten mjete inciuese për investim.<br>• Mund të ketë nevojë për numër ardhës pa pagesë.<br>• Nëse sistemi përdoret për situata emergjente duhet të jetë i pajisur që të mund të ballafaqohet me numër të madh të thirrjeve.<br>• Nëse përdoren për verifikim, porositë patjetër duhet të përtrihen bile edhe si përgjigje të lajmeve të gabueshme, kohës së keqe etj.<br>• Nëse përdoren për paralajmërim të hershëm nevojitet koordinim i aktiviteteve me shërbimet meteorologjike. |

Pasi që shqyrtuam më shumë mjete të kapshme, tani do ta shqyrtojmë rëndësinë e kombinimit të 2 apo më shumë mundësive me qëllim që të zgjedhim qasjen më adekuate.

## Kominimi i mjeteve

Nuk ekziston mënyrë e vetme, më efikase për dërgimin e porosive për edukimin e opinionit. Secili person mëson apo mban mend në mënyrë të ndryshme, nëpërmjet përdorimit të shqisës për shikim, dëgjim, prekje, apo sirezultat i shijes apo aromës së tyre. Hamë dhe flejmë të rrethuar me familjen dhe me fqinjët tanë, në vendet e punës apo bashkësi tjera me miq, fqinjë, kolegë etj. Prandaj suksesi shpesh rezulton nëpërmjet kombinimit të modaliteteve të ndryshme. Më poshtë janë prezantuar shembuj nga e gjithë bota.

## Shembuj të intervenimeve me qasje të ndryshme të kombinuara

- **Nepal –** teatër, këngë popullore, radio programe, mbledhje në bashkësi, edukime moshatare dhe kontakte të realizuara nëpërmjet liderëve fetar.
- **Bangladesh –** të gjitha qasjet e përshkruara më lartë për Nepal kanë të bëjnë edhe me Bangladeshin edhe janë shtuar edhe postere dhe porosi në letër flipçart.
- **Indonezi –** shenja në rrugë për evakuim, trajnime, vizita të familjeve dhe trajnim nga ndihma e parë, ujë dhe sanitacion, edukim shëndetësor, kërkim dhe shpëtim.
- **Shrilankë –** postere, fletushka, bilborde, mbledhje në bashkësi, ngjarje sportive, turnire në kriket, ngjarje në shkolla dhe tombolla.
- **Kolumbi –** këngë dhe video, shfaqe me kukulla, për ngritjen e vetëdijes për ndryshime klimatike tek rinia.
- **Argjentinë –** shfaqe edukative në sipërfaqe publike.
- **Karibe –** radio dramë, radio spote, postere, fletushka dhe reklama në gazeta, për shpërndarje të porosive të sigurta gjatë sezonit të stuhive.
- **SHBA –** mësim online plotësuar me aktivitete vullnetare dhe prani në ngjarje të ndryshme publike për promovimin e aktiviteteve shëndetësore dhe sigurisë.
- **Turqi –** kontakte dhe aktivitete me veprimtarë lokal, liderë fetar dhe kuadër arsimor.

